

Parathënie për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm

I. PARIMET E PUNËS SË GVB

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Njësitë e IAL.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tablo e qartë dhe transparente e Njesisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njesisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.
- Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të kryhet sipas formatit të hartuar nga ASCAL, duke mos bërë asnjë lloj ndryshimi (psh. Bashkim kriteresh, heqje kriteresh, etj.).

II. ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit.

- Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA.
- Njoftohet zyrtarisht Koordinatorin e IAL, për fillimin e procesit të akreditimit, dhe caktohet data e takimit me të për diskutimin e hapave të procesit.
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm; ky grup ngrihet nga titullari i njesisë;
- Trainimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkesë;
- Përgatitja e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV);



- Dorëzimi zyrtarisht në ASCAL brenda afatit të përcaktuar (në versionin e printuar dhe elektronik CD, firmosur / vulosur nga IAL në çdo faqe), materialet të ngarkohen edhe në sistemin AMS të ASCAL.

III. DOSJA E VETËVLERËSIMIT

Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit përfshihet: *Mendimi me shkrim i Drejtuesit të Njësisë dhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm*, i shkruar dhe firmosur nga secili anëtar i GVB.

Kërkohet mendimi i drejtuesit të Njësisë, kur Programi i studimit po kalon fazën e rivlerësimit periodik. Në këtë rast ai do të shkruajë:

- Të dhëna për Institucionin e Arsimit të Lartë që ai drejton;
- Të japë opinionet e veta personale ku të tregohen vlerat e forta, dobësitë dhe perspektiva e programit të studimit për të cilën është përgjegjës;
- Të analizojë zhvillimet kryesore që nga vlerësimi i fundit, duke theksuar sidomos përmbushjen e detyrave të lëna nga vlerësimet e mëparshme;
- Të tregojë gjendjen ekzistuese në raport me atë programi/et e studimit, ka për mision ose synon të arrijë.

PËRMBAJTJA E DOSJES SË VETËVLERËSIMIT

Dosja e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit të programit të studimit duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Mendimi me shkrim i Drejtuesit të IAL (Universitetit/Fakultetit);
2. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i firmosur nga të gjithë anëtarët e GVB. RVB përbëhet nga 6 fusha për programet e ciklit të parë Bachelor.
3. Çdo fushë duhet të analizojë kërkesat e standardit / kritereve, duke përfshirë pjesën përshkrimore dhe duke dhënë tregues të matshëm, bazuar në evidencat e dosjes së vetvlerësimit.
4. Bazuar në këtë analizë GVB duhet të përcaktojë vlerësimin përfundimtar të përmbushjes së standardeve të çdo fushe, dhe fushës në tërësi.
5. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm duhet të përmbajë edhe analizën përfundimtare të institucionit duke vënë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të tij.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
"Shkenca Infermierore"

Grupi i Vlerësimit të brendshëm:

1. Prof. asoc. Dr. Maria Agolli
2. Dr. Dritan Rami
3. Kristjana Dudumi (Student)

Kryetar
Anëtar
Anëtar

Tetor 2023



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Njësia Bazë e Infermierisë, si pjesë e strukturës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, ofron programin e studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore". Ky program studimi është çelur në vitin 2020 me VKM Nr 271, datë 28.08.2020, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve, "Master Profesional", për vitin akademik 2020-2021".

Ky program realizohet në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional, me kohëzgjatje studimi 1 (një) vit, e ndarë në 2 (dy) semestra me një numër kreditesh prej 60 ECTS. Forma e studimit është me kohë të plotë.

Diploma që ofron ky program, Master Profesional në "Shkenca Infermiore", është mjaft e vlefshme për sa u përket mundësive që iu siguron studentëve për karrierë dhe punësim. Programi ndihmon për arritjen e objektivave profesionale në fushat e mësipërme, me synimin e pajisjes së studentit me aftësi dhe njohuri të thelluara të kuadrit zbatues në fushën e studimeve të thelluara infermiore. Qëllimi i programit përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të zhvillimit ekonomik të vendit, nevojës dhe kërkesave të tregut për specialistë të aftë për zgjidhjen e problemeve në fushat e ndryshme shëndetësore. Objektivi kryesor i këtij programi studimi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushat praktike të shërbime infermiore. Programi synon në përgatitjen e specialistëve të lartë me njohuritë e nevojshme për të dhënë shërbim shëndetësor të niveleve bashkëkohore, si dhe aftësimin dhe përgatitjen e studentëve për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problematikave të cdo lloji në fushat mjekësore.

Programi i studimit i Ciklit të Dytë Master Profesional në "Shkenca Infermiore" në përgjithësi synon:

- përgatitjen e specialistëve të lartë me njohuritë e nevojshme rreth shkencave infermiore.
- të mundësojë vazhdimin e karrierës akademike për këta studentë.
- aftësimin e studentëve dhe përfshirjen e menjëhershme në tregun e punës duke i përgatitur ata me njohuritë më bashkëkohore në fushën e Infermierisë.
- përgatitjen e specialistëve të aftë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme të fushës infermiore dhe sigurimin e vendimarrjes së duhur në situatat e ndërhyrjeve urgjente.
- planifikimi dhe menaxhimi i politikave infermiore për parandalimin e sëmundjeve sipas legjislacionit mjekësor në fuqi.
- matja, vlerësimi, analiza dhe menaxhimi i riskut të sëmundshmërive etj.

Ky program studimi përgatit specialistë me cilësi dhe shprehje të larta teknike dhe profesionale drejt një karriere të suksesshme, në përputhje me modelet dhe vizionet bashkëkohore të strukturave spitalore publike dhe private.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në përputhje me Manualin e ASCAL "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit" si edhe shkresës dërguar nga ASCAL në UGJ për "Konfirmim i aplikimit për akreditimin e 20 programeve të studimit" që ofrohen në këtë universitet, si edhe mbështetur në Shkresën e Rektorit të UGJ me nr. 378 Prot. datë 17.03.2023, "Vënie në dijeni për fillimin e procesit të akreditimit të parë për programet e studimit të ofruara nga njësitë bazë të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë", u krijua Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) në NJBKF. GVB është i përbërë nga 2 (dy) anëtarë të stafit akademik që japin mësim në këtë program dhe 1 (një) student.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për procedurën e akreditimit në programin e studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" përbëhet nga:

- | | |
|---------------------------------|---------|
| 1. Prof. asoc. Dr. Maria Agolli | Kryetar |
| 2. Dr. Dritan Rami | Anëtar |
| 3. Kristjana Dudumi (Student) | Anëtar |

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB-së janë marrë parasysh kritere të tilla si: kompetencat profesionale, eksperiencia në mësimdhënie, paanshmëria, aftësitë për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit si dhe aftësitë e punës në grup. Për të përmbushur me sukses procesin e hartimit të raportit për vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi, GVB-ja iu nënshtrua një trajnimit paraprak nga ASCAL. Të gjithë anëtarët e GVB kanë punuar me përkushtim për të pasqyruar në mënyrë të qartë e të plotë gjithë informacionin lidhur me programin e studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore".

Në punën për hartimin e Raportit, GVB-ja ka vepruar bazuar në ndarjen e punës, përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiave për secilin anëtar. Për të siguruar evidencën mbështetëse të nevojshme për këtë raport, përgjithësisht, është shfrytëzuar dokumentacioni i disponueshëm në nivel institucional dhe njësie bazë. Puna e GVB për hartimin e këtij raporti është parë si një detyrë shumë e rëndësishme, sepse paraqet së pari, atë çfarë FSHN përfaqëson në përgjithësi, dhe në veçanti, kujdesin që tregohet për produktin e këtij Institucioni të Arsimit të Lartë: produkti është studenti jo vetëm me diplomë, por edhe me një vend pune gjithashtu.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Shkenca Infermierore”.**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti “E.Çabej”, Gjirokastrë (UGJ), ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Të gjitha programet e studimit të ofruara nga UGJ janë në linjë me politikat kombëtare, në veçanti me punësimin e të rinjve dhe nxitjen e sipërmarrjes, kreativitetit dhe inovacionit. Programet e studimit zhvillojnë, përcjellin dhe mbrojnë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, formojnë specialist të lartë dhe shkencëtarë të rinj, kontribuojnë në zhvillimin ekonomik social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal dhe kontribuojnë në rritjen e standardeve të demokracisë e qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 2, Neni 4, Neni 5, Neni 8; Evidenca I.1.1 Urdhër MASR për miratimin e statutit të UGJ-së; Evidenca I.1.2 Vendim i Senatit Akademik për miratimin e statutit të UGJ-së; Evidenca I.1.3 Vendim i Bordit të Administrimit për miratimin e statutit të UGJ-së]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së, të shprehura në Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Nenet 4, 5, 8], si dhe në Strategjinë e zhvillimit të UGJ-së. [Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025, Misioni, fq. 8, Vizioni, fq. 8]</p> <p>Njësia Bazë e Infermierisë është hapur me Vendim Senati Akademik, Nr. 44, datë 15-05-2007. [Evidenca I.10. Riorganizimi në Infermieri]</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së si dhe me fushën e veprimtarisë së tij. [Evidenca I.20. Urdhri i hapjes së Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”]</p> <p>Programi, përmes krijimit, zhvillimit dhe përcjelljes së dijes përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, synon pajisjen e studentit me aftësi dhe njohuri të thelluara të kuadrit zbatues në fushën e Infermierisë, për të garantuar një karrierë të suksesshme profesionale. [Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në Shkenca Infermierore] Këta elementë si pjesë e misionit të UGJ-së, kontribuojnë njëkohësisht edhe në rritjen e cilësisë së kërkimit në fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit.</p>

	[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 4 dhe 5]			
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" është hapur dhe ushtron veprimtarinë e tij që prej vitit 2020 dhe aktualisht është pjesë integrale e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të UGJ-së. [Evidenca I.20. Urdhri i hapjes së Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore"]</p> <p>Ky program ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë së zhvillimit të UGJ-së [Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë 2020-2025, Misioni, fq. 8, Vizioni, fq. 8], të Statutit të UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nenet 62, 63, 65], të Rregullores së UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nenet 42, 46, 48] si dhe me fushat e drejtimet akademike të UGJ-së.</p> <p>Objektivi kryesor i këtij programi studimi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë, me cilësi dhe shprehje të larta teknike dhe profesionale në fushat e Infermierisë. Në fokusin e tij të plotë, ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar tek studenti mendimin kritik dhe kreativ, si dhe t'i ekspozojë ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e shkencave infermierore, nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur fuqishëm nga praktikatat më të mira. [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në Shkenca Infermierore 2020]</p>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>UGJ-ja është një Institucion i Arsimit të Lartë, themeluar në 1971. [Evidenca I.18 Vendimi i hapjes së ILP-së; Evidenca I.19 Vendimi mbi krijimin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë]</p> <p>UGJ-ja ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit Master Profesional në "Shkenca Infermierore". [Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Në UGJ respektohen kriteret ligjore të titujve dhe gradave të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesëshme) sipas njësive bazë dhe sipas cikleve të studimit.</p> <p>Struktura hierarkike e UGJ-së është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të përcaktuara prej tij, por edhe të programit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" në sajë të përvojës, kapacitetëve dhe burimeve njerëzore. FSHN dhe NJBI që mbulon këtë program</p>

	<p>studimi, nëpërmjet personelit akademik të kualifikuar dhe kapaciteteve që kanë, arrijnë të ofrojnë me sukses këtë program studimi. [Evidenca I.14 Organograma e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca I.15 Organograma e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.16 Organograma e Njesisë Bazë të Infermierisë] ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, (Tabelat 2;4;6)]</p> <p>Gjatë këtij viti akademik nga NJBI, në mësimdhënie në këtë program janë angazhuar 4 (kater) personel akademik efektiv. [Tabela e stafit Akademik të NJBI] Për të garantuar cilësinë e mësimdhënies është marrë në konsideratë niveli i kualifikimit dhe fusha e kërkimit shkencor të secilit anëtar të NJB. Gjithashtu, po për këtë qëllim FSHN ndër vite ka bërë pjesë të tij personel akademik të ftuar me tituj apo grada që kanë qenë një vlerë e shtuar e këtij fakulteti. [Evidenca III.4 CV-të e Personelit Akademik; Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2019 - 2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2021-2022; Evidenca I.12 Raporti Vjetor mbi veprimtarine mesimore-kerkimore të Fakultetit Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2019-2020; Evidenca I.12.2 Raporti Vjetor mbi veprimtarine mesimore-kerkimore të Fakultetit Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2020-2021; Evidenca I.12.4 Raporti Vjetor mbi veprimtarine mesimore-kerkimore të Fakultetit Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021-2022]</p> <p>Nga pikëpamja e infrastrukturës, mjediset e mësimdhënies janë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme dhe sallat janë pajisur me projektore që mundesojnë mësimdhënie bashkëkohore. Gjithashtu, laboratorët janë të pajisur me mjete të teknologjisë së informacionit. Vetëm në 2 vitet e fundit Godines A të FSHN-së i janë shtuar 2 klasa digjitale të pajisura me teknologjinë më të fundit. [Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike, laboratorike dhe teknologjike]</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MP në "Shkenca Infermierore" është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7-të të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në përputhje me nenin 70 pika 4 e ligjit 80/2015 dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Nenet 5, 63]</p> <p>Master Profesional në "Shkenca Infermierore" është një program i fushës Mjekesore-Infermierore i cili ofrohet nga Njësia Bazë e Infermierisë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njesisë kryesore përgjegjëse për këtë program që është Fakulteti i Shkencave të Natyrës. [Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FSHN]</p> <p>Pjesa e stafit akademik të kësaj NJB me tituj dhe gradave aktualisht janë angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. [Aneksi 4. Tabelat Përmbledhese mbi ngarkesën e stafit të NJBI]</p> <p>NJBI bazuar në nenin 86 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 "Për Specifikimet dhe Përbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të</p>



	Lartë të Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave ka propozuar kodifikimin kombëtar të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). [Evidenca I.22. Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FSHN]			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Njësisë Bazë përgjegjëse për këtë program, që është Njësia Bazë e Infermierisë. [Evidenca I.9 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”; Evidenca I.7 Rregullore e Njësisë Bazë të Infermierisë]			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është një program i ofruar brenda profilit të IAL-se dhe FSHN-së dhe cilësia e tij garantohet nga stafi akademik i FSHN-së, në përputhje me nivelin dhe profilin e kualifikimit apo fushës së tyre të kërkimit. [Evidenca III.4 CV-të e Personelit Akademik]			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UGJ gjatë çdo viti akademik organizon aktivitete të ndryshme profesionale, si seminare speciale, workshop-e, diskutime të temave të ndryshme nga lektorët të ftuar nga Universite brenda dhe jashtë vendit, nga përfaqësues të bizneseve, apo organizmave të tjerë vendimarrës brenda vendit, gjatë të cilave synon trajnimin e mëtejshëm të studentëve të saj. UGJ, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit e tij, i fton ata gjithmonë të bëhen pjesë e këtyre aktiviteteve. [Evidenca I.12 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2019-2020; Evidenca I.12.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të 2020-2021; Evidenca I.12.4 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2021-2022; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca I.24. Lista e projekteve të UGJ; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ; Evidenca I.26 Leksione të hapura]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



(Handwritten signatures)

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Strategjia dhe drejtimi i fakultetit bazohet në bashkëpunimin midis njësive bazë. Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit rregullohen përmes Statutit dhe Rregullores së UGJ-së dhe janë në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë. Përgjegjësitë e Njesisë Bazë si dhe të hallkave të tjera të fakultetit janë të mirëpërcaktuara në rregulloren përkatëse të fakultetit. Veprimtaria e UGJ-së drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj, që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, në statut, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetëregulluese të institucionit. [Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Kreu II, III, IV, dhe V; Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së, Kreu II, III, IV dhe V]</p> <p>Njësia Bazë mësimore shkencore, për realizimin e këtij program studimi është Njësia Bazë e Infermierisë. Pesha kryesore e mbarëvajtjes së këtij programi mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse. Në planin mësimor të këtij programi studimi ka lëndë që zhvillohen nga stafi i njësive të tjera bazë si NJBBKM. [Evidenca I.29 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBI për vitin akademik 2020-2021; Evidenca I.29.1 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBI për vitin akademik 2021-2022; Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBI për vitin akademik 2022-2023; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabela 12)]</p> <p>NJBI siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Nenet 10, 47; I.14 Organograma e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I.15 Organograma e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.16 Organograma e Njesisë Bazë të Infermierisë] Veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrativo-financiare e institucionit, pasqyrohet në raportet vjetore institucionale. [Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.1 Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratimin e raportit vjetor 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.3 Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratimin e raportit vjetor 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca I.11.5 Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratimin e raportit vjetor 2021-2022]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në nivel akademik UGJ-ja është aktive përsa i përket marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit si edhe bashkëpunimeve në kuadër të projekteve të ndryshme, realizimit të programeve të përbashkëta, nxitjes së shkëmbimit të stafit akademik. [Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UGJ; Evidenca I.6 Strategjia e zhvillimit të FSHN]</p> <p>Nëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ku</p>

	<p>përfitues janë studentët dhe personeli akademik. [Evidenca L.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca L.24 Lista e projekteve të UGJ; Evidenca L.25 Lista e mobiliteteve të UGJ] Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale. [Evidenca L.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca L.11.3 Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratimin e raportit vjetor 2019-2020; Evidenca L.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca L.11.5 Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratimin e raportit vjetor 2020-2021; Evidenca L.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca L.11.7 Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratimin e raportit vjetor 2021-2022]</p>			
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Praktika Profesionale në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” zhvillohet e gjitha në semestrin e dytë. Bashkëpunimi i Universitetit me Spitalin Rajonal synon krijimin e marrëdhënieve afatgjata dhe të qëndrueshme për shkëmbim përvoja, kryerjen e praktikave profesionale për studentët, financimin e aktiviteteve të UGJ-së apo mbështetjen teknike të tyre, ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe/ose të konsulencës nga UGJ-ja deri tek punësimi i studentëve.</p> <p>Bashkëpunimi me të tretët është i konsoliduar nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm, duke garantuar mbikëqyrjen e vazhdueshme të studentëve gjatë praktikave profesionale. Ky bashkëpunim i ndërsjelltë e ndihmon institucionin të evidentojë nevojat e tregut të punës, si edhe të riorganizojë programin e studimit duke e pasuruar me lëndë të orientuara më tepër drejt praktikës duke mundësuar në këtë mënyrë integrimin më të shpejtë të studentëve në tregun e punës. Po ashtu raporte bashkëpunimi UGJ-ja ka edhe me universitete të tjera vendase dhe të huaja, subjekte private dhe institucione shtetërore. Me të gjithë këta partnerë ka nënshkruar marrëveshje ku janë specifikuar fusha e bashkëpunimit dhe detyrimet e palëve. [Evidenca L.28 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca L.24 Lista e projekteve të UGJ; Evidenca L.25 Lista e mobiliteteve të UGJ]</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>NJBI harton në mënyrë periodike raporte të analizës mësimore shkencore, ku në to përfshihet edhe analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me subjekte të ndryshme shtetërore dhe private.</p> <p>[Evidenca L.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2019-2020; Evidenca L.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2020-2021; Evidenca L.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2021-2022]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Adresa: Rruga “Studenti”

Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekani@nogi.edu.al

Website : <https://nogi.edu.al/>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është një program studimi i ciklit të dytë. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe. [Evidenca I.20. Akti i Hapjes së Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”]</p> <p>Ky program studimi, është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe është në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar. [Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021]</p> <p>Programi ka një kohëzgjatje prej 1 (nje) vit akademik me një total prej 60 kredite ku lëndët/modulet vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kreditet janë caktuar për çdo lëndë bazuar në ngarkesën mësimore në auditor si dhe në punën individuale të studentit, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Njësia Bazë/Departamenti ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e këtij programi studimi Master Profesional dhe ka përgatitur dosjen e plotë të këtij programi. Bazuar në planin mësimor dhe kurrikulën e programit të studimit ky program përfshin 7 module me një total prej 42 kredite, praktika profesionale 6 kredite dhe mikroteza ka 12 kredite.</p> <p>[Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 13, pika 3; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”; Evidenca II.9 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022 Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2021-2022]</p> <p>Në përfundim të këtij programi studimi, studentit i jepet Diplomë Universitare “Master Profesional në “Shkenca Infermierore”. [Evidenca II.6.1 Model suplementi i diplomës Master Profesional në “Shkenca Infermierore”]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” ka si objektiv kryesor formimin e specialistëve bashkëkohorë në fushën e Infermierisë. Ky program gjithashtu synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgatitjen e specialistëve të lartë me njohuritë e nevojshme të thelluara dhe të përditësuara infermierore.

Adresa: Rruga “Studenti”


Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekanishn@uogj.edu.al

Website : <https://uogj.edu.al/>

<p>punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - aftësimin e studentëve për tregun e punës dhe t'i përgatisë ata për karrierat e mëtejshme respektive. - përgatitjen e specialistëve të aftë për zbatimin korrekt të protokolleve infermierore. - ofrimin e një mësimdhënie bashkëkohore duke integruar teorinë me praktikën dhe raste studimore moderne. [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”] <p>Struktura dhe plani mësimor i këtij programi studimi, synojnë të përcjellin tek studentët njohuri teorike dhe praktike të kërkuara nga tregu i punës me qëllim aftësimin e tyre në profesionin përkatës. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2020-2021]</p> <p>Kjo realizohet përmes njohurive të marra gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, projekteve kërkimore si dhe praktikave mësimore, duke harmonizuar njohuritë teorike me ato praktike për të inkurajuar dhe formuar tek studentët mendimin krijues dhe kritik si specialist të ardhshëm për tregun e punës në sektorin privat dhe atë publik. [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ofron një sistem të gjerë njohurish të thelluara infermierore në fushat kryesore si Infeksionet Spitalore, Pediatria, Patologjia, Kirurgjia etj. Kjo realizohet përmes harmonizimit të njohurive teorike me ato praktike për të zhvilluar tek studentët mendimin krijues dhe kritik. Modulet/lëndët janë të ndara sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga instucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndët bazë të kategorisë A – 1 lëndë, 5 kredite, 2. Lëndët karakterizuese të kategorisë B – 4 lëndë, 22 kredite, 3. Lëndët ndërdisiplinore/integruese të kategorisë C – 2 lëndë, 15 kredite, 4. Lëndët plotësuese të kategorisë D – 1 lëndë, 6 kredite, 5. Detyrimet përmbyllëse të kategorisë E – 1 lëndë, 12 kredite (provim formimi/punim diplome). <p>[Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimi i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është i organizuar dhe strukturuar me qëllim thellimin e njohurive që studentët kanë marrë pas përfundimit të studimeve në ciklin e parë Bachelor. Përmes konsolidimit dhe përvetësimit të njohurive më të avancuara në fusha specifike sipas lëndëve që zhvillohen të planin mësimor, studentët kanë mundësi të kuptojnë dhe zgjidhin situatat më komplekse dhe praktike që mund të përballen gjatë eksperiencës të punës në të ardhmen. Hartimi i syllabuseve të lëndëve është</p>

<p>ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>bazuar në kërkesat që lidhen me kuadrin rregulltor të IAL-ve, si garanci drejt një karriere të suksesshme akademike apo profesionale. [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore"; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermierore" 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Struktura e programit të studimit dhe elementët përbërës të programit të tij, gjejnë zbatim në të gjitha kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015; VKM Nr.41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, si dhe dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 i ndryshuar dt. 22.09.2020. Ky program studimi zhvillohet me kohë normale 1 vit akademik i ndarë në dy semestra, në total 60 kredite/ECTS. Programi është në përputhje me Nivelin 7 të Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare. Referuar programit dhe planit mësimor, ky program studimi realizohet përmes ofrimit të 7 moduleve/lëndëve me një total prej 42 kredite, praktika profesionale 6 kredite dhe Mikroteza/Tema e diplomës ka 12 kredite. Struktura e këtij programi studimi ofruar nga Njësia Bazë/Departamenti i Infermierisë në përputhje me kuadrin ligjor, përbëhet nga elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kreditet për secilën lëndë sipas sistemit europian ECTS ▪ Syllabuset e lëndëve, që përfshijnë (format dhe metodat e mesimdhënies, kuadrin e përgjithshëm formues të programit të lëndës, objektivat formues për secilën lëndë, kontrollin e dijeve dhe mënyrën e vlerësimit), ▪ Planin mësimor, i detajuar sipas rubrikave përkatëse ▪ Kriteret specifike të pranimit të studentëve ▪ Diplomën dhe suplementin e diplomës <p>Në fillim të çdo viti akademik, njësia/departamenti harton planin mësimor të mbështetur në kurrikulën përkatëse, dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili miratohet nga dekani i fakultetit. [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore"; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermierore" 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" 2022-2023; [Evidenca II.6.1 Modeli suplementi i diplomës Master Profesional në "Shkenca Infermierore"]</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve në programin Master Profesional në "Shkenca Infermierore" është në përshatje dhe përputhje të plotë me ligjin dhe specifikat e përcaktuara nga ministria e arsimit. Ai është i mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015; VKM Nr.41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, si dhe në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 i ndryshuar dt. 22.09.2020. Gjithashtu mbështetet në rregulloren e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej", rregulloret e Fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore". [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 8] Rregullorja e UGJ-së dhe Rregullorja e Programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit.</p>




	<p>transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Evidenca I.5 Rregullore e FSHN, Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore"]</p> <p>Format e financimit të studentëve përfshijnë financimin nëpërmjet bursave dhe nëpërmjet përjashtimit nga tarifrat e studimit. Financimi bëhet për dy kategori. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kriterëve të tjera të vendosura me aktet nënligjore. Në fillim të çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UGJ. [Evidenca II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifrat 2019-2020; Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuara. Evidenca II.14 Vendimi i BA për trajtimin e studentëve me bursat dhe mbështetje për kategoritë e veç]</p>			
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" është program i ngjashëm që ofrohet edhe në shumë universitete të tjera në Republikën e Shqipërisë, si në Universitetin e Korçës, në Universitetin e Vlorës, etj. Përmbajtja e programeve është e ngjashme në nivel së paku 70%. Programet e ciklit të dytë të studimit, Master Profesional që ofrohen në të njëjtën fushë studimi me universitetet publike në Shqipëri kanë përmbajtje të ngjashme, janë konsistente dhe ofrojnë një përvojë të ngjashme të mësimit për studentët duke garantuar cilësinë dhe standardet e barabarta për të gjithë studentët në këto programe. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2020-2021]</p>			
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në mbështetje të vendimit nr. 310 datë 11.05.2022, për "Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe shkresës nr. 7556/3, datë 17.11.2022, bashkëlidhur udhëzimi nr. 31, datë 15.11.2022 "Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" pika 1, pika 2 dhe pika 12, programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore", ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë. [Evidenca I.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të studimit FSHN]</p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" nuk është program i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj. [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore"]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



(Handwritten signatures)

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret**Vlerësimi**

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Njësia kryesore për programin e studimeve Master Profesional në "Shkenca Infermiore", është Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHNUGJ) i cili është hapur me urdhër të MAS Nr.126 datë 20.03.2017. [Evidenca I.19 Vendim për hapjen e njësisë kryesore FSHN]

FSHN dhe Njësia Bazë përbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësim dhe akreditim.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron programe studimi në ciklin e parë të studimeve, Bachelor, ciklin e dytë të studimeve Master Profesional dhe Master Shkencor. [Evidenca I.5 Rregullore e Njësisë kryesore FSHN, neni 4]

FSHN në UGJ në funksion të përbushjes së misionit dhe objektivave të tij si IAL publike, është i organizuar me një strukturë të tillë që siguron përbushjen dhe objektivat e këtij programi studimi. Kjo njësi kryesore, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi, ka në përbërjen e saj 3 njësi bazë (departamente):

1. Njësia Bazë e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës;
2. Njësia Bazë e Biologji-Kimisë;
3. Njësia Bazë e Infermierisë;


të cilat, bazuar në Nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të lartë, kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore/tituj akademike, si dhe personel ndihmës akademik, pedagogë të jashtëm ose të ftuar.

Njësia Bazë e Infermierisë është hapur me vendim të Senatit Akademik Nr. 44, datë 15.05.2007. [Evidenca I.10. Akti i hapjes Departamenti i Infermierisë]

Programi i Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" është hapur me VKM Nr. 271, datë 28.08. 2020. [Evidenca I.20. Akti i hapjes së Programit të Studimit Master Profesional në Shkenca Infermiore]9

Njësia Bazë e Infermierisë është njësi bazë përgjegjëse e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore për realizimin e këtij programi studimi. [Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2020] Njësia Bazë e Infermierisë. [ANEKS-Tabela Përmbledhëse të personelit akademik FSHN (Tabela 2)] Kjo njësi përbëhet prej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarësh personel akademik efektiv nga të cilët 2 (dy) mbajnë titullin Prof.Asoc.Dr, nga të cilët 1 (një) është mjek me specializim afatgjatë në Mjekësi, 1 (një) është me titullin/gradën shkencore Dóc.Dr. dhe specializim afatgjatë në Mjekësi, 2 (dy) janë me gradën shkencore Dr. dhe me specializime afatgjata në Mjekësi, 1 (një) me gradën shkencore Dr., 1 (një) me Master Egzekutiv dhe 3 (tre) në nivelin Msc. duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë. Njësia Bazë e Infermierisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, jo vetëm efektiv, por edhe atij të ftuar dhe me kontratë. [Evidenca I.7 Rregullorja e Njësisë bazë të Infermierisë, neni 3, 6, 7]

Vlen të theksohet se për sa i përket kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të Departamentit të Infermierisë në pesë vite akademike



	<p>është rritur ndjeshëm kualifikimi. Ne 5 vitet e fundit në këtë Departament janë shtuar 3 (tre) grada shkencore "Doktor i Shkencave Mjekesore", dhe në vitin 2023 ka fituar titullin Profesor i Asociuar I (një) anëtar stafi. Anëtarët e tjerë janë në përgatitje të dosjeve për marrjen e grades Dr. [Evidenca I.29 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBI për vitin akademik 2019-2020; Evidenca I.29.1 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBI për vitin akademik 2020-2021; Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBI për vitin akademik 2021-2022; Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBI për vitin akademik 2022-2023]</p> <p>UGJ ka marrë akreditimin periodik institucional me Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. [Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik] Ky program studimi i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia Bazë e Infermierisë në përbërjen e saj ka aktualisht, 1 anëtar si personel akademik të Njesisë Bazë të Biologjisë, Kimisë dhe Mjedisit dhe 2 (dy) personel me kohë të pjesshme, që ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies. [Evidenca I.16. Organograma e njësisë bazë të Infermierisë]</p> <p>Në funksion të këtij program studimi janë 2 (dy) laboratorë të Infermieristikës, 2 (dy) laboratore me nga 30 PC, 2 (dy) videoprojektorë, 2 (dy) ekrane të mëdhenj murale etj. Personeli ndihmës akademik në FSHNUGJ pranë Departamentit të Infermierisë është me nivelin Msc. në Biologji, Kimi dhe Mjedis edhe po avancojnë me studime universitare në fushën e "Infermier-Mami" dhe "Infermieri e Përgjithshme". Ky personel ndihmon në realizimin e procesit të mësimdhënies si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe pajisjeve përkatëse në to. [Evidenca I.27 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrative, Nenet 7, 8, 9; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE- (Tabelat 1 dhe 2)]</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësitet bazë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, për realizimin sa më mirë të objektivave si dhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor kanë përcaktuar një personel akademik në rolin e koordinatorit. Për programin e studimeve Master Profesional në "Shkenca Infermiore", koordinatori është përgjegjës i njësisë bazë/departamentit i cili përfaqëson autoritetin drejtues të njësisë bazë. [Evidenca I.7. Rregullorja e Njesisë Bazë të Infermierisë], [Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë kryesore FSHN, neni 11] Ai bashkëpunon, koordinon dhe monitoron me strukturat e tjera përgjegjëse mbarëvajtjen e ecurisë së zhvillimit të mësimit, angazhohet në zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë semestrit; ndjek zhvillimin e mësimit në përputhje me objektivat e programit dhe syllabuset e lëndëve, etj. [Evidenca I.7. Rregullorja e Njesisë Bazë të Infermierisë, neni 4; Evidenca 5. Rregullore e Njesisë kryesore FSHN, neni 11]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës si njësi kryesore dhe Departamenti i Infermierisë si njësi bazë që është përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, disponojnë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, me Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar, me Statutin e UGJ-së, [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 65] si dhe me Rregulloren e Universitetit [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenet 48, 66] disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e Njesisë Bazë të Infermierisë. [Evidenca I.7. Rregullorja e Njesisë bazë të Infermierisë] • Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere”. [Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere” 2020] • Planin mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere”. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiere” 2020-2021] • Programet (syllabuset) e lëndëve mësimore. [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere” 2022-2023] • Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. [Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021] • Model i diplomës Master Profesional në “Shkenca Infermiere”. [Evidenca II.6.1 Model i diplomës Master Profesional në “Shkenca Infermiere”] • Suplementi i diplomës. [Evidenca II.5 Model suplementi i diplomës] • Struktura mësimore 2022-2023. [Evidenca II.29 Struktura Mësimore Master Profesional në “Shkenca Infermiere”] • Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere”. [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabela 6)]
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Format e veprimtarive mësimore, numri i javëve mësimore sipas semestrave, numri total i provimeve sipas semestrave. • Ndarjen e lëndëve mësimore sipas semestrave. • Ndarjen e lëndëve mësimore sipas aktiviteteve formuese.



mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

- Ngarkesën në kredite, numrin total të orëve, numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe orëve në javë.
- Komponentët mësimorë për secilen lëndë
- Formën e vlerësimit

[Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermirore”; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermirore” 2020-2021]

Shpërndarja e lëndëve referuar planit mësimor sipas semestrave janë si në vijim:

Nr	Lëndët	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese				
		Orë në auditor	Leksione	Seminare	Laboratore	Orë jashtë auditorit
Viti I						
Semestri I						
1	Menaxhimi i Infeksioneve Nozokomiale	60	45	15	-	65
2	Menaxhimi i Urgjencave Pediatrike	60	45	8	7	65
3	Menaxhimi i Pacientit në Mjekesine Interne	60	45	8	7	65
4	Teknikat Infermirore Bashkekohore	120				
Semestri II						
5	Menaxhimi i Pacientit Kirurgjikal					
6	Menaxhimi i Pacientes në Obstetrike-Gjinekologji	59	45	9	5	66
7	Lende me zgjedhje: a.Kerkimi Shkencor në Infermieri b.Promocion Shendetesor c.Toksikologji Klinike					
8	Praktika Profesionale	150				-
9	Teze Diplome					300
Gjithsej Viti I						

[Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermirore”]



<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 51, Neni 61-Neni 65], Rregullorja e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Kreu VI] dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës] përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të studentëve, kriteret dhe kuotat e transferimit të studentëve në ciklin e dytë të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore", propozohen nga Njësia Bazë e Infermierisë, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores së UGJ-së, Statutit të UGJ-së, dhe Udhëzimeve të MAS. [Evidenca II.10.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021; Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022; Evidenca II.12.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2021-2022; Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studenteve]</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" përmbajnë gjithë elementet e nevojshëm në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr.879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementët e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar. [Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore"; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2022-2023]</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Çdo fillim viti bëhet rishikimi i lëndëve apo moduleve sipas gruplëndëve të cilat reflektojnë zhvillimet ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ato të shkencës dhe teknologjisë së informacionit. Në syllabuset e lëndëve rishikohen dhe shmangen tema të ngjashme apo të njëjta midis lëndëve. Gjithashtu rishikohet literatura duke përditësuar dhe përfshirë në tekste apo cikël leksionesh të reja. Diskutimi përfundimtar për ndryshimet përkatëse, bëhet në mbledhjen e departamentit për të marrë miratimin përpara fillimit të vitit të ri akademik.</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plot.</p> <p>[Evidenca I.5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në UGJ; Evidenca II.7.1 Dërgim në MAS të organizimit të planet mësimore; Evidenca II.7.2 Kthim përgjigje nga MAS për organizimin e planit mësimore]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve të këtij programi studimi, është në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, mundësojnë një thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme të studentëve. Lëndët referuar kurrikulës dhe planit mësimor synojnë formimin e studentit në fushën përkatëse. Objektivi kryesor i këtij program studimi është përgatitja e specialistëve të lartë me njohuri më të thelluara në fushat e asistencës infermiere. Programi i lëndëve dhe plani mësimor ofrojnë njohuri bazë teorike si dhe aftësi për punë të pavaruara për studime të mëtejshme.</p> <p>[Evidenca I.9. Rregullorë e Programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere”; [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiere” 2020-2021], [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere” 2022-2023]</p> <p>Në përfundim të studimeve ky program i pajis studentët me një formim të lartë profesional në fushën infermiere dhe menaxhimin e situatave të ndryshme mjekësore, i cili do tu shërbejë për të qenë të sukseshëm në tregun e punës ose për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e tretë dhe aktivizimin në jetën akademike.</p> <p>[Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; Evidenca II.21 Urdhër MAS për përzgjedhjen e literaturës në IAL; Evidenca II.22 Miratimi i literaturës bazë në MP në SHI 2020-2021 Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ; Evidenca II.24 Lista e fituesve Master Profesional në “Shkenca Infermiere” 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiere”, bazuar në Rregulloren e programit të studimit, dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimit Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar, ofron lëndë të ndara në:</p> <p>a) Lëndë bazë, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme në fushën e Infermierisë</p> <p>b) Lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik në fushën e Infermierisë.</p> <p>c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit si: Teknikat Infermiere Bashkëkohore, si dhe grup-</p>


Adresa: Rruga “Studenti”

Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekani@univgjirokastrer.edu.al


Website : <https://univgjirokastrer.edu.al/>

	<p>lëndë me zgjedhje si: Kerkimi Shkenor në Infermieri, Promocion Shëndetësor, Toksikologji Klinike.</p> <p>d) Lëndë plotësuese, të fokusuar në përfitim të aftësive në praktikën profesionale në një nga institucionet private ose publike, nën udhëheqjen e pedagogëve përkatës.</p> <p>e) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin e përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Në përfundim të studimeve ky program i pajis studentët me një formim profesional në fushën e “Shkenca Infermierore”, i cili do të shërbejë për të qenë të sukseshëm në tregun e punës ose për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e tretë apo edhe programe apo trajnime licënsimi në profesione të rregulluara në të gjitha shërbimet spitalore si Infeksionet në çdo pavion spitalor, shërbimi i avancuar në pavionin e Pediatrisë, Patologjisë, Kirurgjisë dhe Maternitet.</p> <p>[Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2020-2021; Evidenca II.3 VKM Nr.41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3 .1.VKM nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021]</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është fokusuar kryesisht në dhënien e njohurive të nevojshme teorike dhe praktike për tregun e punës si dhe karrierat e mëtejshme respektive.</p> <p>Organizimi i programit të studimit është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme kombëtare / ndërkombëtare dhe në bazë të Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS).</p> <p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, raporti teori praktikë, janë në përputhje me profilin e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”, e përafërt me programe të ngjashme kombëtare / ndërkombëtare.</p> <p>[Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ]</p> <p>Kurrikula e programit të Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, mesatarisht 30 kredite për semestër. Raporti i orëve është në pjesën më të madhe 3/1 (3 orë leksion dhe 1 orë seminar) apo 2/0.5/0.5 (3 orë leksion 0.5 orë seminar dhe 0.5 orë laborator) duke i dhënë rëndësi rritjes së aftësive të studentëve në ushtrimin dhe aplikimin e njohurive teorike të marra në përputhje me profilin e programit. Ngarkesa në kredite për një vit është 60 ECTS, një praktikë kjo e njëjtë me programet të ngjashme ndërkombëtare. [Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2022-2023]</p> <p>Programi i lëndëve të këtij programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që i krijon studentëve mundësi transferimi të studimeve, pasi përmbajtja është e krahasueshme me njohuritë që studenti mund të marrë në institucione të tjera brenda apo jashtë vendit. [Evidenca I.1. Statuti i Universitetit Eqrem Cabej, neni 72; Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në UGJ, neni 65; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studenteve]</p>




<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve është realizuar me synimin që studenti të ketë afërsi për tu përshtatur sa më shpejt në tregun e punës në përputhje me njohuritë e marra gjatë periudhës së studimeve si dhe zhvillimin drejt një karriere të sukseshme në profesion apo për ndjekjen e studimeve në ciklin e tretë të studimeve. [Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2020-2021]</p> <p>Programi i lëndëve të këtij programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që i krijon studentëve mundësi transferimi të studimeve, pasi përmbajtja është e krahasueshme me njohuritë që studenti mund të marrë në institucione të tjera brenda apo jashtë vendit. Natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. [Evidenca I.1. Statuti i Universitetit Eqrem Cabej, neni 72], [Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në UGJ, neni 65; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2020-2021; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve]</p> <p>Formimi teoriko-praktik mundëson punësim në përfundim të studimeve. [Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit; Evidenca II.21 Urdhër MAS për përzgjedhjen e literaturës në IAL; Evidenca II.22 Miratimi i literaturës bazë në MP në SHI 2020-2021; Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ]</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset (programet e lëndëve) e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura.</p> <p>Hartimi i programeve lëndore organizohet nga grupet mësimore kërkimore nën drejtimin e Përgjegjësit të grupit mësimor kërkimor, diskutohen dhe miratohen në Departament. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Cabej” Gjirokastër, Neni 19, pika 2/b]</p> <p>Titullari i lëndës depoziton pranë Njesisë Bazë programin lëndor (syllabusin) të nënshkruar prej tij. Para fillimit të lëndës çdo pedagog i paraqet studentëve syllabusin e lëndës, së bashku me modalitetet e përfshira në të për zhvillimin e mësimi.</p> <p>Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Botimet e reja të fushave përkatëse të studimit, rezultatet e punës shkencore, integrohen me koncepte në lëndët përkatëse. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar synohet të jetë bashkëkohore. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2022-2023; Evidenca II.21 Miratimi i literaturës bazë në MP në SHI 2020-2021]</p>

<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është e organizuar me lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse dhe garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, të pasqyruara në çdo program lëndor (syllabus) në seksionin, "Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit".</p> <p>Rezultatet e të nxënit maten me anë të realizimit të objektivave të lëndës të cilat janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të ndara në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës. Pas përfundimit të këtij programi studimi, studentët kanë përfituar njohuritë dhe kompetencat e nevojshme, për tu punësuar në institucione në nivel publik dhe privat. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2022-2023; Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>NJBI është kujdesur që përmbajtja e programit të studimit, "Master Profesional në "Shkenca Infermiore"" të jetë tërheqëse dhe e përshtatshme për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin të studentëve. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që studentët të kenë mundësi të përshtatshme me lehtësi në kërkesat e tregut të punës dhe të ndjehen të përgatitur për sfidat që do të hasin në karrierën e tyre të ardhshme. Për të arritur këtë objektiv, është hartuar një kurrikul e pasur, që përfshin njohuri thelbësore dhe aftësi praktike në fushën e infermieristikes. Përveç kësaj, është përfshirë praktika profesionale, duke i dhënë studentëve eksperiencën praktike të nevojshme për të integruar njohuritë teorike me situata reale në fushën e ndërhyrjeve të thelluara infermiore. Kjo i mundëson studentëve të mësojnë dhe të zhvillojnë aftësi që janë të vlefshme për tregun e punës. Gjithashtu programi mësimor është i përditësuar sipas ndryshimeve të kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve të reja në fushën publike dhe private. Bazuar në këto përpjekje dhe përshtatshmëri të programit tonë, gjykojmë se përmbajtja e tij mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në mënyrë të përshtatshme me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>FSHNUGJ dhe Departamenti i Infermierisë për realizimin e këtij programi studimi gjithashtu mbështeten në një bashkëpunim afatgjatë dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Rajonal, si dhe me institucione të tjera të sektorit mjekësor publik. [Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ]</p> <p>Panairi i karrierës që zhvillohet nga UGJ, është një aktivitet që rrit bashkëpunimin me institucionet publike dhe private duke rritur mundësitë për punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesave të tregut të punës. Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" u mundëson studentëve të ndjekin një karrierë të mëtejshme profesionale dhe akademike në përputhje me objektivat e këtij programi. [Evidenca I.7. Rregullore e Njësisë bazë të Infermierisë, neni 2; Evidenca II.15. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore" 2022-2023]</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>FSHNUGJ ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me aktorë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik dhe atij privat. [Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit] Departamenti i Infermierise në hartimin dhe përgatitjen e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” ka pasur në konsideratë nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për profesionistë të aftë e të mirëfilltë në fushën e infermierise, si një nevojë e domosdoshme e zhvillimeve të shpejta të aplikimit të teknikave të reja në sektorin shëndetësor. Departamenti i Infermierisë bashkëpunon me institucione si Spitali Rajonal apo Urdhri i Infermierit Gjirokastrë. Pjesëmarrja e stafit akademik në strukturat vendimmarrëse dhe konsultative të këtyre institucioneve dhe organizatave publike, ka bërë të mundur që departamenti të marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve për të përmirësuar përmbajtjen dhe modulet e këtij programi studimi me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. [Evidenca II.15. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UGJ nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatën Akademik të UGJ-së, janë të organizuar në Këshillin Studentor të UGJ, dhe kanë Statutin e funksionimit të tyre. [Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik; Evidenca II.25 Statuti i Këshillit Studentor; Evidenca II.26 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor] Nëpërmjet zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, UGJ mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar për përmirësimin e programit të studimit. [Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 9; Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ; Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>NJBI përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me institucione publike e private. [Evidenca II.30 Vendim Senati për Menaxhimin e projekteve; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca I.24. Lista e projekteve të UGJ; Evidenca I.25. Lista e mobiliteteve të UGJ]</p> <p>Gjithashtu, departamenti bashkëpunon me institucione publike si Spitali Rajonal apo Urdhri i Infermierit Gjirokastrë. Pjesëmarrja e stafit akademik në strukturat e këtyre institucioneve ka bërë të mundur që departamenti të marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve për të përmirësuar përmbajtjen dhe modulet e këtij programi studimi me qëllim rritjen e mundësive të punësimit të studentëve</p>



	në tregun e punës. [Evidenca II.15. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Ndërtimi dhe organizimi i programeve të studimeve në UGJ, udhëhiqet nga nevoja dhe fleksibiliteti, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave në tregun e punës. Objektivat e programit të studimit Master Profesional në "Shkencat Inermierore" janë në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit. Njësia bazë e Infermierise ka prioritet që të ofrojë një program studimi me në qendër studentin, për ti përgatitur për një karrierë produktive dhe profesionale dhe për të qenë të aftë dhe të përgjegjshëm në ofrimin e shërbimeve profesionale me interes privat dhe publik. [Evidenca I.1 Statuti i UGJ-së; Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së; Evidenca I.7 Rregullore e Programit të Studimit MP; Evidenca II.28, II.28.1, II.28.2 Syllabuset e lëndëve]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia Bazë e Infermierisë mbështet, nxit dhe respekton stafin akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimin e tyre. Departamenti si njësia bazë, nxit dhe mbështet, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore-shkencore, duke respektuar lirinë akademike të stafit akademik. [Evidenca I.1 Statuti i UGJ-së; Evidenca I.7 Rregullore e Programit të Studimit MP; Evidenca II.28, II.28.1, II.28.2 Syllabuset e lëndëve; Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës]
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit ka si qëllim t'u mundësojë dhe ofrojë studentëve pjesëmarrjen në projekte dhe aktivitete kërkimore dhe shkencore. Studentët janë nxitur gjithmonë dhe janë përfshirë në aktivitete, kërkime, studime dhe projekte të ndryshme. Gjithashtu ata kanë bashkëpunuar me pedagogët në realizimin e studimeve apo punimeve për tu paraqitur në konferenca shkencore. Studentët e këtij programi studimi me mbështetjen e pedagogëve të departamentit kanë marrë pjesë në konferenca shkencore, trajnime dhe workshop-e të ndryshme. [Evidenca I.7 Rregullore e njësisë bazë të Infermierisë; Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2021-2022]
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Institucioni angazhohet që të mbështesë aktivitetet kërkimore dhe studimore të Njësive Bazë, duke qenë se kërkimi dhe projektet kërkimore shkencore janë pjesë e objektivave që merren parasysh në hartimin e projekt buxhetit të institucionit. Në këtë kuadër, personeli akademik i këtij departamenti është mbështetur nga institucioni për organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore. Gjithashtu për realizimin e aktiviteteve studimore, institucioni vë në dispozicion pajisjet

Adresa: Rruga "Studenti"

Lagja "18 Shtatori", Gjirokastër 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekanifshn@uogj.edu.al

Website : <https://uogj.edu.al/>

	teknologjike, laboratorëve dhe gjithëçka të nevojshme për këtë proces. [Evidenca I.1 Statuti i UGJ-së; Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2021-2022; Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në NJBI]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse mbështet, nxit dhe respekton grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkimin shkencor. Gjithashtu, ajo mbështet stafin akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimit të tyre. Kjo mundëson shkëmbimin e njohurive dhe resurseve, duke krijuar mundësi për projekte të mëdha dhe të ndryshme kërkimore. Njësia kryesore/FSHN dhe njësitë bazë janë të përfshira në disa projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe kanë një sërë marrëveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus +, që mundësojnë mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të këtij fakulteti. [Evidenca I.1 Statuti i UGJ-së; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ. me institucione brenda dhe jashtë vendit; Evidenca II.28 Syllabuset e lëndëve; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ-së; Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	NjBI ka një staf akademik të kualifikuar dhe të specializuar në fusha të ndryshme shkencore. Ky staf ka përvojë të pasur në kryerjen e analizave, studimeve dhe projekteve me karakter kërkimor-shkencor. Personeli akademik është i aftë për të kontribuar në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe për të përgatitur analiza të cilat mund të përdoren për të adresuar sfidat dhe problemet e duhura në fushat e tyre të ekspertizës. Kjo njësi bazë është përkushtuar në inkurajimin dhe mbështetjen e studentëve për tu angazhuar në projekte kërkimore, duke i përfshirë në trajnime dhe orientime për studentët mbi metodologjitë e kërkimit shkencor, si dhe ndihmë praktike dhe financiare për të ndihmuar studentët në kryerjen e analizave dhe studimeve të tyre. [Evidenca I.24 Lista e Projekteve të UGJ]; Evidenca III.15. Plani i veprimtarive akademike kërkimore-shkencore; Evidenca I.13 Raport vjetor Njësia Bazë e Infermierisë 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raport vjetor Njësia Bazë e Infermierisë 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raport vjetor Njësia Bazë e Infermierisë 2021-2022]
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose	Në programin e Masterit Profesional në "Shkencë Infermierore", njësia bazë është kujdesur për organizimin e aktiviteteve të përshtatshme që kontribuojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e komunitetit të tij, të akademikëve dhe studentëve.


Adresa: Rruga "Studenti"
Lagja "18 Shtatori", Gjirokastër 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekani@uog.edu.al
Website : <https://uog.edu.al/>



<p>aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Njësia bazë ndihmon në krijimin e një mjedisi të pasur akademik dhe në promovimin e zhvillimit të profesionalizmit, duke inkurajuar dhe suportuar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore, konferenca shkencore të organizuara nga fakulteti, si dhe konferencat shkencore studentore të organizuara nga shoqatat studentore. Njësia kryesore/FSHN dhe njësitë bazë janë të përfshira në disa projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe kanë një sërë marrëveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus +, që mundësojnë mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të këtij fakulteti. [Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ]</p> <p>Gjithashtu Njësia Bazë e Infermierisë ka qenë e angazhuar në organizimin e konferencave shkencore mbi zhvillimet e fundit në fushën e Infermieristikës, problematikave dhe sfidave për të ardhmen e këtij profesioni. Në këto konferenca ka marrë pjesë stafi akademik, studentët si dhe profesionistë të fushës. Organizimi i konferencave dhe punimet e paraqitura në to paraqesin interes të veçantë për palët e interesit, duke trajtuar çështje të rëndësishme për studentët në kërkimet e tyre shkencore të mëtejshme si dhe për përgatitjen e mikrotezave. [Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.I 2019-2020; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.I 2020-2021; Evidenca I.13.3 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.I 2021-2022; Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermirore" përfshin një kurrikulë të pasur me lëndë të specializuara dhe njohuri më të thelluara në fushën e menaxhimit të situatave të shumëllojshme mjekesore dhe infermirore, që e sjellin studentin në një nivel të lartë të kompetencës në fushën e studimit. Ky program përgatit studentë të suksesshëm në tregun e punës dhe i jep atyre një kompetencë të përshtatshme që mund të aplikohet jo vetëm në nivelin vendas, por edhe në nivelin ndërkombëtar.</p> <p>Programi është i përfshirë në bashkëpunim me institucionet mjekesore dhe ofron mundësi praktikash të punës. Bashkëpunimi me institucione të sektorit shëndetësor studentët të zhvillojnë aftësi praktike të përshtatshme për tregun e punës.</p> <p>Nga analiza e të dhënave të zyrës së Alumni, [Evidenca II.18 Databazë Alumni; Aneks: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)], rezulton se punësimi i të diplomuarve në programin e MP në SHI ka qenë në rritje, ku pjesa më e madhe është punësuar në përputhje me diplomën. [Evidenca VI.6 Plan vjetor i Sektorit të standarteve të cilësisë dhe kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.1 Plan vjetor i Sektorit të standarteve të cilësisë dhe kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.2 Plan vjetor i Sektorit të standarteve të cilësisë dhe kurrikulave 2022-2023; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Njësia bazë e Infermierisë gjatë punës së saj fokusohet në sigurimin e pajtimit të programit të studimit me kërkesat dhe standardet e licencimit përkatës në fushën e Infermierisë. Programi i studimit MP në SHI përgatit studentët me kompetencat dhe njohuritë e nevojshme për të marrë licencën e profesionit si infermierë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm. Njësia Bazë siguron përmirësimet e vazhdueshme të programit në mënyrë që programi të ketë ndjekur dhe zbatuar rekomandimet dhe standartet e nxjerra nga urdhrat profesionale, institucionet profesionale dhe rrjetet profesionale për fushën mjekesore dhe infermirore.</p>

	<p>Gjatë vitit akademik 2020-2021 ka nisur nje program për të realizuar rekomandimet dhe përsosur aftësitë infermierore në përputhje me standardet profesionale. Programi ka përfshirë kompetencat e nevojshme të licencimit në kurrikulën e tij e cila përmban lëndë dhe aktivitete që zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të marrë licencën e profesionit infermieror. [Evidenca VI.6.1 Plan vjetor i Sektorit të standarteve të cilësisë dhe kurrikulave 2020-2021; Evidenca II.9.1 Plani mësimor MP në SHI 2021-2022; Evidenca II. 28 Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit Master Profesional në SHI 2022-2023; Evidenca II.9 Vendim miratimi plane mësimore MP në SHI; Evidenca II.8.1 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022]</p> <p>Njësisia bazë për programin e studimit ka kontakte aktive me shoqatat profesionale dhe rrjetet profesioniste në fushën e infermierisë. Ky kontakt përfshin prezantime nga profesionistë të fushës, mundësi për praktika profesionale, dhe pjesëmarrjen në ngjarje dhe aktivitete profesionale. Programi i Masterit Profesional në Shkenca Infermierore fokusohet në përmirësimin e përgatitjes së studentëve për t'u bërë profesionistë të aftë e të suksesshëm në fushat kryesore të infermierisë duke përfshirë programin me standardet dhe kërkesat ligjore të fushës. [Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ]</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Kujdes i veçantë është treguar që programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" të përputhet me të gjitha aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare, duke përfshirë direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian, siç është Direktiva e Kualifikimeve Profesionale (Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU). Ky është një aspekt thelbësor i integritetit dhe cilësisë së këtij programi të studimit, sepse siguron studentët që të pajisen me njohuritë dhe kualifikimet e nevojshme për të praktikuar profesionin e infermierit në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit përputhet me ligjet dhe rregulloret vendase dhe ndërkombëtare që rregullojnë profesionet e rregulluara, përfshirë direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Gjithashtu ky program studimi përputhet me ligjet dhe rregulloret vendase që rregullojnë praktikën dhe licencimin e profesionit në vendin tone, ku përfshihen përputhjet me kërkesat për licencë, trajnimin, dhe kompetencat e nevojshme për të ushtruar profesionin që do të profilizohen në vazhdim pas diplomimit. Anëtarët e njësisë Bazë në mënyrë të vazhdueshme njihen, monitorojnë dhe përditësojnë programet dhe kurrikulat me ndryshimet në ligjet dhe rregulloret që rregullojnë profesionet e rregulluara. Njësisia Bazë bashkëpunon me autoritetet kompetente dhe institucionet publike dhe private për monitorimin e përputhjes me rregulloret.</p> <p>Programi i studimit i përgatit studentët për të përballuar provimet dhe kërkesat e licencimit për profesionet e rregulluara. Programi i studimit MP në SHI është në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë profesionet e rregulluara, duke përfshirë ato të vendit dhe të Bashkimit Evropian dhe ngre bazat kryesore të përgatitjes së studentëve për të përballuar sfidat e licencimit dhe për të përmbushur kërkesat e nevojshme për të praktikuar profesionin me sukses. [Evidenca II.26 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në SHI; Evidenca II.27 Struktura Mësimore Master Profesional në "Shkenca</p>




	Infermierore"; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Në rregulloren dhe në planin mësimor të programit të studimit janë të përcaktuara metodat kryesore të mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve që janë leksionet, seminarat, ushtrimet, provimet e formimit/punimi i diplomës. Ndërsa në syllabuset e secilës lëndë jepen më të detajuara metodat e mësimdhënies, forma e kontrollit të dijeve në varësi të llojit të lëndës. [Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Kontabilitet-Financë; Evidenca II.9.1. Plani mesimor Master Profesional në KF 2021-2022]</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional, realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik. Lëndët që ofrohen në këtë program janë të organizuara në kategori të klasifikuara nga A në E. Format e mësimdhënies për këtë program studimi janë ato të miratuara nga institucioni, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksionet: 354 orë mësimore në auditor - Seminarat: 95 orë mësimore në auditor - Laborator: 43 orë mësimore në auditor - Praktikë profesionale 150 orë në auditor - Provim formimi/Punim diplome: 300 orë në auditor - Orë mësimore jashtë auditorit janë në total 858 <p>Gjithsej 60 kredite/ 642 orë mësimore në auditor dhe 858 orë mësimore jashtë auditorit.</p> <p>Ndarja e lëndëve sipas kategorive nga A në E:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë të formimit të përgjithshëm bazë (simboli A): 5 kredite - Lende të formimit karakterizues (simboli B): 22 kredite



	<ul style="list-style-type: none"> - Lëndë ndërdisiplinore/integruese lëndë-nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (simboli C): 15 kredite - Lëndë plotësuese për njohjen e gjuhës së huaj, aftësive informatike, (simboli D): 6 kredite - Provim formimi/Punim diplome (simboli E): 12 kredite <p>Gjithsej: 60 kredite. [Evidenca II.9.1. Plani mesimor Master Profesional në SHI 2021-2022; Evidenca II.28. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik është i gatshëm t’iu përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve duke ofruar forma e metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Një shembull evident ishte përshtatja e metodave të mësimdhënies duke përdorur platformat mësimore online gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p>Gjithashtu në varësi të natyrës së lëndëve, në veçanti ato me natyrë aplikative, është rritur pesha në vlerësimin e detyrave individuale të kursit mbi të dhëna të mbledhura nga vetë studentët.</p> <p>Leksionet zhvillohen mbi bazë kursi. Në përputhje me kapacitetin e sallave ose me metodën e zhvillimit të leksioneve, kursi mund të ndahet në 2 pjesë kur numri i studenteve kalon nga 120. Seminaret zhvillohen me grupe 25-40 studentë, por jo me pak se 5 studente. Në këtë mënyrë mësimi zhvillohet në mënyrë interaktive, duke integruar shpjegimin e pedagogut me diskutimet e studentëve në mënyrë që ata të jenë sa më aktivë në seminare por edhe leksione gjithashtu. Në rregullore përcaktohen qartë elementet e vlerësimit të vazhdueshëm si: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndermjetëm, projekte, detyra kursi etj, përfaqëson deri në 20% të vlerësimit total. [Evidenca III.5 Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie; Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”; Evidenca I.5. Rregullore e Njesise Kryesore FSHN, neni 23, 29, 32; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”; Evidenca II.9.1. Plani mesimor Master Profesional në SHI 2021-2022]</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, UGJ ofroi alternativën online të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet platformave elektronike të mësimit në distancë, Classroom, Edumect, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams. Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesimin, të studentëve dhe personelit akademik në këto platforma, nëpërmjet mbështetjes nga personeli IT i Universitetit si dhe ndihmoi me dokumentacionin e nevojshëm teknologjik (manuale) për përdorimin e këtyre platformave [Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimit online; Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimit online Classroom; Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimit online Edumect; Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimit online Office 365; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet; Evidenca III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mesimor 2020-2021; Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të</p>

	<p>provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.10 Zhvillimi i sezonit të provimeve FSHN 2020-2021; Evidenca III.1.11 Orari i konsultimeve gjatë periudhës së pandemisë; Evidenca III.1.12 Orari i mesimeve online 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UGJ mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin të infrastrukturës së mësimdhënies duke ofruar auditor të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies • Modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gadishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor [Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në DIF] • Krijimit të oportuniteteve për stafin akademik për zhvillimin e kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e workshop-e në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj, për të përsosur metodat e mësimdhënies [Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ-së; Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ] • Hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. [Evidenca III.5 Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie; Evidenca III.5.1 TECOMP-Strategjia për përmirësimin e cilësisë; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.5.3 TeComp Kompetencat didaktike dhe pedagogjike (përkthyer nga UGJ); Evidenca III.5.4 TeComp Kompetencat digjitale (përkthyer nga Universiteti i Korçës)] • Përdorim të librarive elektronike [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit] <p>Edhe gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 në kuadër të zhvillimit të mësimin në distancë (online) në funksion të një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më efektive në UGJ u organizuan trajnime të personelit akademik/ndihmës akademik mbi përdorimin e platformave të mësimdhënies në distancë. [Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe</p>	<p>Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi ka eksperiencën dhe kualifikimin përkatës akademik bazuar në lëndët të cilat zhvillojnë mësimin. Institucioni i jep rëndësi të vecantë procesit dhe kriterëve që aplikon në rekrutimin e personelit akademik. Kjo është e theksuar dhe në strategjinë e Zhvillimit të UGJ-së ku midis të tjerave theksohet se UGJ-ja synon rekrutimin e pedagogëve të kualifikuar ose në proces kualifikimi dhe parashikon çdo vit vende të lira pune për staf akademik bazuar në strategjinë "Brain Gain". [Evidenca I.3. Strategjia e Zhvillimit të UGJ – Rekrutimi i stafit të ri akademik]</p> <p>Gjithashtu rregullorja e brendshme e UGJ-së parashikon kriteret të përgjithshme të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë (sipas kategorive/gradave/titujve) dhe atij me kohë të pjesshme. Njësitë bazë</p>

<p>ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>respektive përcaktojnë kritere shtesë të vecanta të rekrutimit. [Evidenca I. 27. Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrative;] Aktualisht, për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i NJBI i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 8 (tetë) anëtarë personel akademik efektiv (PAE), të kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2 (dyë) Lektorë me titullin “Profesor i Asociuar” • 1 (një) Lektor me titullin/gradën shkencore “Doc.Dr.” • 4 (katër) Lektorë me gradën shkencore “Dr.” dhe specializim afatgjatë në mjekësi • 1 (një) Lektor me specializim afatgjatë në mjekësi <p>Për të pasur një mësimdhënie sa më interaktive, personeli akademik integron shpjegimin me pyetjet/diskutimet e studenteve, përdor raste studimore apo shembuj ku kërkohet diskutim, si edhe nxit pjesëmarrjen e studentëve në prezantimin e këtyre rasteve studimore përpara studentëve të tjerë, përmes përdorimit të <i>power point</i> etj, në mënyrë individuale apo edhe përmes krijimit të grupeve të bashkëpunimit. Përdorimi i këtyre metodave interaktive nxisin autonominë, përgjegjshmërinë, krijimtarinë, frymën e bashkëpunimit dhe fleksibilitetin tek studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>NJBI në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera bazë stafi i të cilave është gjithashtu i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, nxjerr konkluzione mbi efektivitetin e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, në varësi të ecurisë së studentëve dhe përmirëson metodat e mësimdhënies për t’iu përshtatur më mirë studentëve. Kjo realizohet jo vetëm nga diskutimet në Njësinë Bazë por edhe me studentët gjatë procesit mësimor. Përfshirja e studentëve në përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies bëhet edhe nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të hartuar nga vetë institucioni si edhe Sondazhit Kombëtar të Studentëve që zhvillohet çdo 3 vjet nga ASCAL. Mendimet dhe sugjerimet e përfuara shërbejnë si bazë për përmirësim të mëtejshëm.</p> <p>Spektori i cilësisë së standardeve dhe kurrikulave si pjesë integrale e UGJ është përgjegjës për hartimin e standardeve institucionale të cilësisë në mësimdhënie, dhe kërkim shkencor. [Evidenca I.1. Statuti i UGJ, neni 93, 94; Evidenca III.5. Strategjia për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies; Evidenca VI.6.1 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6. Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023; Evidenca VI.6.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Evidenca III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit; Evidenca III.7 Analiza e pyetësoreve dhe percjellja në fakultete]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së</p>	<p>Institucioni organizon struktura të posacme për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Këto struktura janë përgjegjëse dhe koordinohen me njësitë kryesore/bazë për sigurimin e brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati akademik - Spektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave <p>Këto njësi si pjesë integrale të universitetit në bashkëpunim me Njësinë Bazë përgjegjëse për këtë program studimi, mbështesin përmirësimin e cilësisë së</p>

mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	mësimdhënies. Në veçanti njësi bazë ka rolin kryesor në promovimin dhe mbështetjen e metodave inovative të mësimdhënies. Kjo reflektohet në mësimdhënien e shumë lëndëve, në të cilat, në varësi edhe të natyrës së lëndës, si pjesë e procesit të vlerësimit përfundimtar përfshihen edhe projektet, detyrat e kursit, rastet studimore etj. I gjithë stafi i FSHN-së është i përditësuar me zhvillimet e reja në fushat përkatëse, të cilat i reflekton në përmirësimet e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	


Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit, e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të UGJ-se, [Evidenca L.2. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, kreu VI, neni 68, kreu VII, nenet 81-83 dhe neni 89] në rregulloren e studimeve të UGJ-së, [Evidenca L.4 "Rregullore e studimeve në UGJ", kreu V, neni 39] në Rregulloren e posaçme në nivel njësie kryesore, [Evidenca L.5. "Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, kreu VI, neni 32] në Rregulloren e Njesisë Bazë të Infermierisë, [Evidenca I. 7. Rregullore e njesisë Bazë Infermierisë kreu IV, neni 13], në Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore". [Evidence L.9.1 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore", kreu II, neni 11]</p> <p>Në këto rregullore përcaktohet vlerësimi dhe kontrolli i dijeve i ndarë në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar (20% të vlerësimit total) dhe vlerësimi në provimin final (80% të vlerësimit total). Përcaktimi i këtij raporti përcaktohet në rregulloret e njësive kryesore dhe evidentohet në syllabusin e çdo lënde. Gjithashtu përcaktohet sistemi i vlerësimit me notë të studentit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem prej 10 notash. Nota kaluese më e ulët është nota 5. Në provimet me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pike, rezultati i të cilit detyrimisht kthehet në notë.</p> <p>Këto rregullore janë bërë publike në faqen zyrtare të Universitetit dhe njihen nga studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Në fillim të çdo lënde, në javën e parë të mësimin, studentët informohen mbi programin e plotë të lëndës dhe të gjithë elementët përbërës të tij nga titullari i lëndës. Siç u përmend edhe në kriterin 1 janë syllabuset që përcaktojnë në mënyrë të detajuar strukturën specifike të vlerësimit të secilës lënde.</p> <p>[Evidenca L.4 Rregullore e studimeve në UGJ, kreu V, neni 26; Evidenca L.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, kreu VI, neni 34; Evidenca L.7. Rregullorja</p>

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	e njësisë bazë Infermierisë Kreu IV, neni 13; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" Kreu II, nenet 10, 11]			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Rëndësi e veçantë i kushtohet metodologjisë së testimit për vlerësimin e njohurive (vlerësimi i vazhduar dhe përfundimtar). Vlerësimi i dijeve të studentëve mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm të vlerësuar me pike (në total 100 pikë.) Konvertimi në note i pikëve të marra nga vlerësimet, përcaktohet në syllabus.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Frekuentimi, aktivizimi dhe niveli i diskutimit në seminare, punë individuale dhe në grup 20%. Ky rezultat iu bëhet i ditur studentëve me mbarimin e procesit mësimor të lëndës përkatëse, përpara provimit. - Provimi përfundimtar me shkrim 80% <p>Format e vlerësimit përfundimtar zhvillohen sipas programit të çdo lënde të miratuar në fillim të vitit akademik. Ato janë të ndryshme për t'i dhënë mundësinë studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, kreu V, neni 34; Evidenca I.7. Rregullorja e njësisë bazë Infermierisë Kreu IV, neni 13; Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" Kreu II, neni 11; Evidenca II.28. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në SHI 2022-2023]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Kontrolli i dijeve për çdo lëndë është i vazhdueshëm, kjo me qëllim mbajtjen angazhuar të studentit gjatë gjithë zhvillimit të lëndës. Vlerësimi i vazhduar reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Nota përfundimtare, si kombinim i vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar parashikohet në syllabuset e lëndëve sipas specifikave të secilës lëndë. Njësia bazë që ofron programin e studimit Master Profesional në SHI ka parashikuar testimin e vlerësimit të njohurive si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Pjesëmarrja në seminare, aktivizimi dhe diskutimi, detyra praktike 20% -Provimi përfundimtar 80% <p>[Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, neni 21, neni 32; Evidenca II.28. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në SHI 2022-2023]</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	<p>UGJ zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF. Studenti është i njohur me metodologjinë e zhvillimit të provimit gjatë procesit mësimor. Personeli akademik asistohet nga koordinatori i AADF pranë</p>

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universitetit të Gjirokastrës, për korrëgjimin e provimeve me këtë sistem elektronik. [Evidenca III.8 Marrëveshje Bashkëpunimi AADF-UGJ; Evidenca III.7. Tezë provimi që ka përdorur Clean Score]</p> <p>Gjatë 2 viteve akademikë 2019-2020 dhe 2020-2021, në kushtet e pandemisë (Covid19), institucioni ka përdorur si metoda inovative platformat mësimore Google Classroom dhe Office 365-Microsoft Teams për zhvillimin e sezoneve përkatëse të provimeve, në përputhje me rregullore të posaçme, mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online, për të shmangur mënyrën e abuzimit dhe rritjen e transparencës. Në të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program, provimi zhvillohet nga 2 pedagogë, si rrjedhojë edhe komisionet që testojnë studentët përbëhen nga 2 pedagogë, njeri prej të cilëve është titullari i lëndës. [Evidenca 4. Rregullore e studimeve në UGJ, kreu V, neni 44]</p> <p>https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesim-in-online/</p> <p>Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimin online; Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimin online Classroom; Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimin online Edumeet; Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimin online Office365; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët; Evidenca III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021; Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 39] dhe në programin e lëndës [Evidenca II.26 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në “Shkenca Infermierore” 2022-2023] vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës, i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar. • Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar. <p>[Evidenca III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve]</p> <p>Bazuar në Rregulloren e UGJ [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 81, pika 1] në përfundim të procesit mësimor (në orën e fundit të mësimin) çdo pedagog që është përgjegjës lënde u komunikon studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fitimin ose jo të së drejtës për tu futur në provimin e lëndës përkatëse • Rezultatit e vlerësimit të vazhduar <p>Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 89]</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënir.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme të kontrollit gjatë semestrit (teste, provim i ndërmjetëm, detyrë kursit, provim final). Korrëgjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit. Njohja me rezultatet paraprake të provimit u bëhet me dije studentëve nëpërmjet publikimit online në librezën e tyre elektronike (në sistemin ESSE3, tashmë në</p>

<p>për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>sistemin Pitagora) ose pranë DIF-së brenda 6 diteve nga data e zhvillimit të tij. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 90] Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta që të rishikojnë individualisht tezat e korigjura prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigje të tyre (të shoqëruara me komente / feedback, këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen) dhe të paraqesin ankesat e tyre eventuale në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut. Kjo e drejtë e studentëve garantohet në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 46]. Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimi për rezultatin e provimit nga studenti.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Personeli akademik i NJBI ndjek rregulla strikte për të evituar çdo formë të plagjiaturës, apo kopjimit në provime dhe detyra, për studentët që frekuentojnë programin e studimit. Ata ndjekin dhe zbatojnë rregullat e provimeve të përcaktuara në rregulloren e studimeve në UGJ, [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 44, pikat 9, 10] në Rregulloren e UGJ, [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nenet 86, 87, 88] në Kodin e Etikës [Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 23, 24] dhe në syllabuset e çdo lënde nëpërmjet "Vërejtjeve përfundimtare nga pedagogu i lëndës", hapësira ku pedagogu parashtro mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik. [Evidenca II.28. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në SHI 2022-2023] Studentët, janë të detyruar të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës së Universitetit "E.Çabej" Gjirokastrë, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në këtë Universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre (mos kopjimi, mos mashtrimi gjatë procesit mësimor, plagjiaturat e çdo forme, etj.), të përcaktuara në Kodin e Etikës. [Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 25, 26] Procesi i provimit monitorohet nga komisioni i provimit, duke mos lejuar kopjimin në provime. Gjithashtu pedagogët e çdo lënde janë të kujdesshëm për të shmangur këtë fenomen edhe në projektet apo detyrat e kursit. [Evidenca I.2. Rregullore e UGJ kreu VII.; Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës]</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>UGJ, u garanton studentëve të drejtën për vlerësimin dhe marrjen e rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale që bazohen mbi meritë [Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Neni 8, pika 2] Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Vlerësimi përfundimtar përbëhet nga vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar u jepet studentëve në përfundim të procesit mësimor. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 81, pikat 1]</p>



	<p>Teza e provimit, bazuar në Rregulloren e UGJ [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 83, pikat 1, 2], përmban pyetje që përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, dhe për çdo pyetje/ushtrim paraqiten pikët përkatëse.</p> <p>Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin e fletoreve është përgjegjësi i departamentit ose një person i autorizuar prej tij. Sekretimi bëhet në prani të komisionit. [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 34, pika 6]</p> <p>Rezultatet e vlerësimit përfundimtar jepen në kohë sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 90], Rregulloren e FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 34, pika 16] dhe në Rregulloren e DIF-së [Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Infermierisë, Neni 31, pika 16]</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët në Universitetin "E.Çabej" Gjirokastrë, gëzojnë të drejtën të njihen me vlerësimin e dijeve dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit për të gjitha format e kontrollit të dijeve të përcaktuara në syllabusin e lëndës përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare dhe njëkohësisht në raste paqartësisish, ata kanë të drejtë të rishikojnë personalisht tezën e korrigjuar në prezencë të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e duhura. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 90; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nenet 45, 46]</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Çdo kërkesë, ankimim në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, të bëra prezent prej studentëve, parashikohet hollësisht në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 46]</p> <p>Ankesa bëhet me shkrim brenda afatit të ankimimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Ai përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me rregulloren atëherë me propozim të përgjegjësit të Departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënie e provimit. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 46, pika 2]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere" është i organizuar në mënyrë të tillë që përgjatë kohëzgjatjes së studimeve studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi të thelluara që i përkasin fushës së Infermierisë, përfshirë këtu edhe njohuri më të thelluara dhe të avancuara në specialitete më specifike si Infeksionet Nozokomiale,</p>

<p>profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Urgencat Pediatrike etj. Studentëve iu jepen njohuritë e nevojshme për t'u bërë specialistë të lartë me njohuri rreth organizimit dhe funksionimit të sektorit publik, por dhe atij privat. Ky program jep një sistem të gjerë njohurish në fushën e menaxhimit infermieror të situatave të ndryshme mjekësore sipas pavioneve, me të cilat studenti është njohur dhe ka fituar njohuritë themelore në programin e ciklit të parë. [Evidenca II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në SHI për vitin akademik 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në SHI 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Gjatë studimeve, pjesë e programit janë lëndë që zhvillojnë aftësitë e studentëve mbi drejtimin e menaxhimit infermieror të situatave të ndryshme mjekësore sipas pavioneve, me të cilat studenti është njohur dhe ka fituar njohuritë themelore në programin e ciklit të parë. [Evidenca II.28. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në SHI 2022-2023; Evidenca II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermiere" për vitin akademik 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në SHI 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Hartimi, analizimi, shqyrtimi dhe përmirësimi i programeve lëndore organizohen nga grupet mësimore kërkimore nën drejtimin e Drejtuesit të grupit mësimor kërkimor. [Evidenca I.2 Rregullorë e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 19, pika 2/b]</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde të programit mësimor Master Profesional në "Shkenca Infermiere", studentët informohen në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe rezultatet e të nxënit të fituara në përfundim të saj. [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere" 2022-2023]</p> <p>Gjatë gjithë procesit mësimor dhe në veçanti në përfundim të lëndës, personeli akademik orienton studentët duke vendosur theksin në temat më të rëndësishme të trajtuara në lëndën mësimore. Në përfundim të semestrit akademik, personeli akademik realizon orë të veçanta konsultimi gjatë të cilave studentët orientohen mbi çështjet më të rëndësishme, si dhe çdo pyetje që ata mund të kenë mbi lëndën përkatëse. [Evidenca III.1.11 Orari konsultimeve gjatë periudhës së pandemisë FSHN]</p> <p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, evidentohen me rezultatet e tyre në format e ndryshme të vlerësimit të vazhduar përgjatë vitit si dhe në provimet përfundimtare.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të</p>	<p>Programet lëndore në programin e studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere", kanë të përfshirë rezultatet e të nxënit në formën e kompetencave që fiton studenti.</p> <p>Njohuritë e mara teorikisht zhvillohen më tej në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Realizimin e orëve të ushtrimeve/ laboratorëve në auditor - Studimin individual jashtë auditorit - Realizimin e projekteve apo detyrave të kursit, etj. <p>[Evidenca II.26 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere" 2022-2023]</p> <p>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke krijuar kushtet dhe favorizuar organizimin e punës në grup gjatë orëve të seminareve, soancat laboratorike, detyrat e kursit dhe studimit individual.</p> <p>Gjatë këtij procesi studentët kanë në dispozicion dhe bibliotekën dixhitale në UGJ dhe një fond librash, të cilat ndihmojnë studentin për të zhvilluar njohuritë, për t'u aftësuar</p>




<p>përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ky fond ndihmon studentin për studime të përparuara kërkimore shkencore. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit] UGJ dhe personeli akademik i DIF-së mbështet studentët për të promovuar idetë dhe mendimin e tyre si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të programit të studimit apo në programe mobiliteti, në konferenca, projekte apo seminare studentore. [Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ-së]</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Përveç lektorëve të ftuar të cilët trajtojnë tematika të ndryshme brenda apo jashtë programit të studimit, personeli akademik i UGJ realizon përgjatë gjithë vitit akademik leksione/seminare të hapura mbi zhvillimet e reja që kanë të bëjnë me programet e studimit që institucioni ofron. Në këto takime përfshihen edhe studentët e UGJ duke ju mundësuar atyre zgjerimin e njohurive që i takojnë posaçërisht programit të studimit që ata ndjekin dhe jo vetëm. [Evidenca III.15 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2019-2020; Evidenca III.15.1 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të 2021-2022; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023]</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>UGJ ndjek një politikë mbështetëse të ideve inovative, projekteve kërkimore të studentëve dhe i mbështet financiarisht ato. Në strategjinë e zhvillimit të UGJ si objektivi i kërkimit shkencor midis të tjerave renditet edhe mbështetja financiare për përfshirje gjithnjë e më të gjere në projektet kërkimore-shkencore jo vetëm e stafit akademik por edhe e studentëve. [Evidenca I.3. Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025; Kërkimi dhe Studimet Shkencore; e) Objektivat] Në faqen zyrtare të UGJ, vazhdimisht publikohen njoftime/thirrje për studentët e interesuar në pjesëmarrje në konkurse, aplikime për fitimin e bursave të studimit, shkolla verore/dimërore apo programe Erasmus +. https://uogj.edu.al/category/njoftime/page/2/ https://uogj.edu.al/programi-erasmus/ http://www.uogj.edu.al/upload/Konkursi%20Punimeve%20K%C3%A4Brkimore%203.jpg</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Vlerësimi</p> <p>Zhvillimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës për studentët e programit e ciklit të dytë Master Profesional në "Shkencë Infermiere", mbështetet në Kreun VIII "Diplomim", të Rregullores së Studimeve në UGJ, Nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64 [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër], Nenin 93 të Rregullores së UGJ [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër], Kreun VII "Diplomim", Nenet 38, 39 të Rregullores së FSHN [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës] dhe në Rregulloren e programit të studimit Master</p>



	<p>Profesional në "Shkenca Infermiere". [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere", Neni 13]</p> <p>Në rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FSHN-së dhe Rregulloren e programit të studimit në MP në "Shkenca Infermiere" përcaktohet qartë pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkangjitur Rregullore së studimeve në UGJ. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 59, pika 3; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 38, pika 2; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere", Neni 13, Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullore së Studimeve]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere" është program i ciklit të dytë të studimeve dhe mbyllet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.</p> <p>Në fillim të vitit të fundit të studimeve DIF asiston studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, në respektim të Rregullore së studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 61] dhe shtojcave të kësaj Rregulloreje [Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullore së Studimeve], Rregullore së programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere" [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiere", Neni 13] dhe Programit të provimit të përgjithshëm. [Evidenca III.11.2 Manual i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullore së Studimeve]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar/mbrojtja e punimit të diplomës realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të Njesisë Bazë, të fushave që mbulon programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. Anëtarët e komisionit propozohen nga Njësia Bazë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 62, pika 3, Neni 64]</p> <p>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga personeli akademik i NJBI-së, miratohet nga Përgjegjësi i NJBI, si dhe Dekani i Fakultetit. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 62, pika 2; Evidenca III.11.1 Listë me tema të përgjithshme për diplomim Master Profesional]</p> <p>Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen në përputhje me programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani. Provimi përfundimtar zhvillohet me gojë dhe studentit i vihen në dispozicion teza që përmbajnë pyetje nga lëndët që ai ka zhvilluar përgjatë afatit të kohëzgjatjes së studimeve, ku peshë specifike me të madhe kanë lëndët e profilit të menaxhit infermior në situatat e ndryshme mjekesore [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 62, pika 4; Evidenca III.12.1 Model i</p>

	<p>unifikuar i tezës së provimeve; Evidenca III.11.1 Miratimi i fushave të studimit të diplomës MP në SHI]</p> <p>Komisioni i posaçëm i miratuar për administrimin e provimit të diplomës harton tezën në përputhje me programin e formimit. Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar përmbajnë pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë dhe miratohen nga Dekani [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 62, pika 4; Evidenca III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Njësia Bazë, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktojnë fushat e studimeve për punimin e diplomës [Evidenca III.11.1 Miratimi i fushave të studimit]. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.</p> <p>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullore së studimeve në UGJ. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 61; Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullore së Studimeve]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Njësia Bazë ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të tij për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. [Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBI; Evidenca III.3. Inventari i mjeteve laboratorike në NJBI]</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe nëse nota është kaluese ai fiton 15 kredite. Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 62, pika 5 dhe 6, Neni 64 pika 3 dhe 4; Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullore së Studimeve; Evidenca II.9.1. Plani mesimor Master Profesional 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë</p>	<p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mesimor dhe ka shlyer provimin e formimit apo ka mbrojtur punimin e diplomës pajiset me diplomën perkatese, shoqeruar, me fletën e notave dhe suplementin e diplomes. [Evidenca I.5. Rregullore e FSHN, kreu VII, neni 41; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 65; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 76; Evidenca II.5 Model diplome Master Profesional në “Shkenca Infermierore”; Evidenca II.6.1 Model suplementi i diplomës MP në SHI]</p>



zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Suplementi i Diplomës për programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR-së [Evidenca IL.6.2 Udhëzim Nr.11, dt. 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR]</p> <p>Pas diplomimit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me syllabuset përkatëse.</p> <p>Elementët përbërës, forma e diplomës, dhe procedura për regjistrim miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. [Evidenca L.1. Statuti i UGJ, neni 76; Evidenca IL.6.1 Model Suplementi i Diplomës Master Profesional në SHI]</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni ruan përgjatë viteve të studimit kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Më pas studentët, në mbyllje të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>UGJ në përputhje me Nenin 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 44] si dhe Rregullore e Sekretarisë Mësimore [Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4] administron dokumentacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrin themeltar të studentëve. • regjistrin e arritjeve akademike. • regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. <p>[Evidenca 5. Rregullore e njësisë kryesore FE, kreu VII, neni 41]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” ofrohet praktika profesionale në semestrin e dytë. Për realizimin e praktikës profesionale, UGJ ka një bashkëpunim të gjerë me institucionet e shëndetësore publike për të mundur realizimin e praktikës mësimore në përputhje edhe me objektivat dhe specifikat që ka programi i praktikës profesionale. Bashkëpunimi me institucionet shëndetësore publike është i konsoliduar nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm, duke garantuar mbikqyrjen e vazhdueshme të studentëve gjatë praktikave profesionale. Ky bashkëpunim i ndërsjellët e ndihmon institucionin të evidentojë nevojat e tregut të punës, si edhe të riorganizojë programin e studimit duke e pasuruar me lëndë të orientuara më tepër drejt praktikës duke mundur në këtë mënyrë integrimin më të shpejtë të studentëve në tregun e punës.</p> <p>Për realizimin e praktikës mësimore, UGJ-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione publike rajonale dhe lokale: Drejtoria e Spitalit</p>



	Rajonal, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqetore dhe Shëndetësore, ISKSH-Gjirokastrë etj. [Evidenca I.23. Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ-së.]			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Përgjatë semestrit të II, studenti falë bashkëpunimit të nënshkruar midis UGJ-së dhe Institucioneve publike rajonale e lokale, asiston në mjediset e tyre dhe përdor teknologjinë që vetë këto insitucione zotërojnë për të parë nga afër mënyrën e realizimit të punës, procedurat e ndryshme që ndjekin këto institucione në varësi edhe të specifikave që vetë institucioni ka. Vetë afati 6 - javor që korresponon me gati 30% të semestrit të fundit, të vitit të parë të studimeve master profesional në SHI, i jep mundësi studentit që të përshtatet me klimën e institucionit, duke lejuar në këtë mënyrë përfitimin më të mire të njohurive dhe kompetencave profesionale.			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Në përfundim të praktikës profesionale, studenti bën mbrojtjen e saj para një komisioni prej dy pedagogesh duke paraqitur një listë me dokumenta si edhe vërtetimin përkatës lëshuar nga titullari/administratori i institucionit publik ku ai ka realizuar praktikën të cilat shqyrtohen dhe studenti vlerësohet me notën përkatëse. Kur studenti vlerësohet me notë kaluese nga komisioni i praktikës profesionale, përfiton dhe kreditet përkatëse të saj (në total 6 kredite). [Evidenca I.5. Rregullore e FSHN, neni 29; Evidenca II.9.1. Plani mesimor Master Profesional në "Shkenca Infermierore", 2020-2021]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në	Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohen në realizimin e programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, bazuar në Nenin 25, pika 4 dhe Nenin 59,

<p>realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>pikat 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” pasi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin, dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit dhe ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës. [Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 6.1, 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Master Profesional në “shkenca Infermierore”]</p> <p>Niveli i kualifikimit të personelit akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e lëndëve të tij. [Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 6.1, 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore”; Evidenca III.4 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës]</p> <p>Kualifikimet dhe publikimet e personelit akademik pasqyrohen në Raportet Vjetor të Grupeve mësimore kërkimore si pjesë e Raportit Vjetor të veprimtarisë mësimore shkencore të DIF-së, dhe në Raportet Vjetore të veprimtarisë mësimore kërkimore të FSHN-së. [Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DIF 2019 -2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DIF 2021-2022; Evidenca I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2019-2020; Evidenca I.12.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2020-2021; Evidenca I.12.5 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2021-2022]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, bazuar në Nenin 59, pikat 3, 4, 5, 6 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe V.K.M Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”.</p> <p>Personeli akademik efektiv i NJBI është i kualifikuar. Kemi 1 (një) lektor që mban titullin “Profesor i Asociuar”, 1 (nje) me Gradën “Docent Doktor”. dhe 2 (dy) me gradën “Doktor” dhe Specializim Afatgjatë në Mjekesi.</p> <p>Ky personel akademik mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermierore” dhe pjesa tjetër e ngarkesës plotësohet nga personel akademik i Departamentit të “Bilogji-Kimise” me gradën “Profesor i Asociuar.”</p> <p>[Evidenca IV.1 V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017, pika 2, gërma a, nënpika XII, pika 2, gërma b, nënpika I, nënpika II; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë</p>	<p>NJBI ka një personel akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe</p>



<p>qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, informacion ky i konfirmuar edhe nga Zyra e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të UGJ-së. [Evidenca IV.3 Listëpagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik Janar-Maj 2023; Evidenca IV.3.1 Model Kontratë punësimi]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UGJ harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 56; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 27, 29; Evidenca I.27 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 3, 5, 8 dhe 9]</p> <p>DIF, bazuar në nevojat e tij, përcakton kriteret e përgjithshme [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 27] dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit. [Evidenca IV.4 Propozim për personel akademik me kohë të plotë, Evidenca IV.4.1 Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar]</p> <p>Kërkesa për punësim i përcillet Rektorit të Universitetit, ku pas miratimit, publikohet në Buletinin e Prokurimeve Publike [Evidenca IV.4.2 Buletini prokurimeve publike] si dhe në faqen zyrtare web të Universitetit.</p> <p>Rektori me urdhër ngre një komision “ad-hoc” për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant, me 5(pesë) anëtarë, i përbërë nga Dekani i Fakultetit i cili kryeson komisionin, [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 33, gërma “h”] 3 (tre) anëtarë pjesë e e personelit akademik të Njesisë bazë përkatëse dhe 1(një) anëtar nga Rektorati. Struktura e manaxhimit të burimeve njerëzore mbështet komisionin “ad-hoc” në zhvillimin e procedurave konkurruese [Evidenca IV.6 Procedurë e punësimit të personelit akademik në DIF]</p> <p>Në rastin e konkursit të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar komisioni “ad-hoc” ngrihet nga Dekani i Fakultetit. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 33, gërma “f”]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 45; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 37; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN, Neni 15]</p> <p>Pjesë përbërëse e FSHN-së në ndihmë të realizimit të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjes së laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore, janë edhe 2 (dy) personel ndihmës akademik me karakter mësimor, i cili zotëron aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës. [Evidenca I.15 Organograma e FSHN; Evidenca III.4 CY-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik]</p>



<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Nenet 41, 42], funksionon Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike Administrative (DSHNA), e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative parashikuar në Rregulloren e saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi [Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, nenet 4, 5; Evidenca IV.3.3 Model dosje personeli].</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë CV-të e personelit, kartën e identitetit, pozicionin e punës, diplomatat dhe listat e notave, gradat shkencore dhe titujt akademik, dëshmi të gjuhëve të huaja, dëshmi të trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme, dëshmi penaliteti, raport mjeko-ligjor etj.</p> <p>Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik në UGJ funksionon Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, i cili mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesëmarrjes në projekte kombëtare/ndërkombëtare, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e workshop-e.</p> <p>[Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 17]</p> <p>Të dhënat përfshijnë gjithashtu edhe angazhimin e personelit akademik në çdo vit akademik dhe semester si dhe planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik, të dhëna që arkivohen pranë NJBI.</p> <p>[Evidenca I.7 Rregullore e NJBI, Neni 8; Evidenca IV.8 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca IV.8.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik]</p> <p>Në Statutin dhe Rregulloren e UGJ-së, përcaktohen edhe detyrat e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor.</p> <p>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 45, pika 3; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 41;]</p> <p>Mbledhja, ruajtja dhe përditësimi për çdo vit akademik i këtyre të dhënave, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. [Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>UGJ, në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Pedagogë të kualifikuar të këtij departamenti ndjekin studentët në praktikat mësimore duke i sqaruar e këshilluar për problemet e ndryshme që mund të dalin gjatë këtyre praktikave.</p>




<p>studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>NJBI në fillim të semestrit të dytë të studimeve në Master Profesional, në Shkenca Infermierore, përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. [Evidenca III.11.1. Miratimi i fushave të studimit] Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 6I, Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve] NJBI ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të FSHN për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit.</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, vazhdimisht ndihmon studentët në përbushjen e detyrimeve gjatë praktikës mësimore, në raportin përfundimtar të praktikës si dhe jep gjykimin e vet në procesin e vlerësimit të studentëve për praktikën profesionale.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UGJ ushtron aktivitetin e tij në 3 (tre) godina universitare: Godina A me sipërfaqe 3255.5 m², Godina B me sipërfaqe 1937 m² dhe godina C me sipërfaqe 729.6 m². [Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ] Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. [Evidenca IV.10.1 Leje higjieno sanitare]. Godinat plotësojnë standartet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluar nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat shtrihen në qendër të zonës urbane larg zonave të zhvillimit industrial apo me ndotje, të cilat gjenden në periferi të qytetit.</p> <p>UGJ i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15–20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). UGJ ka një sistem të mbrojtjes së shkarkësive atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundra zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollët e çdo godinë janë të instaluar bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shogëruar edhe me sinjalistikën përkatëse. [Evidenca IV.10.2 Çertifikatë për sigurinë nga zjarri]</p>



	<p>Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave sisteme ajri të kondicionuar, ndërkohë që Godinat A, B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar (kaldaja). UGJ disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (një motogenerator në Godinën A) dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, pasi uji është i pandërprerë 24 orë.</p> <p>Bazuar në Raportin e MAS-së mbi “Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024”, UGJ ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 m²/student, llogaritur kjo në dy fasha orare kjo normativë shkon në 5 m²/student</p> <p>[Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024]</p> <p>UGJ siguron mjediset të përshtatshme në funksion të veprimtarisë mësimore dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” dhe lëndëve të tij, si dhe në përputhje me standartet dhe normativat për infrastrukturën, të përcaktuara në V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 “Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre.</p> <p>[Evidenca IV.1 V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017; Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)]</p> <p>Veprimtaritë mësimore si leksionet dhe seminarët e programit të studimit, zhvillohen kryesisht në Godinën A.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”, UGJ ka vendosur në dispozicion të Departamentit të Infermierisë klasa, laboratorë, si dhe mjedise të tjera për personelin akademik dhe ndihmës akademik, të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe wifi Internet, në ndihmë të përgatitjes dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>[Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DI; Evidenca III.3 Inventari i DIF]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për plotësimin e kërkesave të lëndëve mësimore, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” në tërësi, NJBI disponon 2 (dy) laboratorë të Infermieristikës (Godina A, Sallat 403 dhe 404) të pajisura me aparatura dhe mjetet e përshtatshme laboratorike, disponon 2 (dy) klasa dixhitale (Godina A, Sallat 401 dhe 402) të pajisur me PC, rrjete kompjuterike dhe wifi Internet, videoprojektorë dhe ekrane dixhitale. [Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBI; Evidenca III.3. Inventari i mjeteve laboratorike në NJBI]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UGJ në tërësi dhe FSHN në veçanti disponon disa laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ai ofron.</p> <p>FSHN disponon 2 (dy) laboratorë të Informatikës (Godina A, Sallat 401, 402) të pajisur me programe kompjuterike. [Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ; Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBI]</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>UGJ garanton, me kapacitetet që zotëron dhe në bashkëpunim me subjekte të tjera publike dhe private, (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), se mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Studentët e degës Master Profesional në “Shkenca Infermiore” zhvillojnë praktikën mësimore në Spitalin Rajonal “Omer Nishani” duke përvetësuar më mirë në këtë mënyrë njohuritë e mara në auditor. [Evidenca I.28 Marrëveshje me të tretët për praktikat mësimore]</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në zbatim të Rregullores së studimeve në UGJ, literatura bazë e detyrueshme në Master Profesional në “Shkenca Infermiore”, përbëhet nga tekste mësimore dhe ciklet e leksioneve të cilat perfeksionohen vazhdimisht, mbështetur në literaturën më bashkëkohore. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 27; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në SHI]</p> <p>Literatura bazë dhe ndihmëse e lëndeve që i përkasin fushës së Shkenca Infermiore ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja (jo e detyruar) dhe mbështetet kryesisht në tekste mësimore të botuara nga autoritete të mirënjohur shkencorë të Universiteteve publike, kryesisht Universitetit të Tiranës. Literatura bazë dhe ndihmëse u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike dhe/ose digjitale, dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi.</p> <p>Gjithashtu, fondi i literaturës fizike dhe online në Bibliotekën e Universitetit mbështet marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.</p> <p>Literatura bazë dhe ndihmëse propozohet nga anëtarët e personelit akademik, shqyrtohet dhe aprovohet nga NJBI dhe pasqyrohet në programet lëndore të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca II.22 Miratimi i literaturës bazë në NJBI 2020-2021; Evidenca II.22.1 Miratimi i literaturës bazë në FSHN 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2022-2023]</p>



<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>NJBI, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. [Evidenca IV.13 Kërkese për blerje librash] Propozimet e NJBI miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. [Evidenca IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin]</p> <p>Edhe Biblioteka paraqet kërkesat e saj për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik, duke kërkuar të ketë një zë përkatës në buxhetin institucional. Përveç pasurimit periodik që realizohet me fondet e UGJ-së, literatura e Bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve të miqve të UGJ-së. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve, me një literaturë të pasur bashkëkohore, është Biblioteka Akadematike, e cila ndodhet në Godinën C të Universitetit. Biblioteka disponon 3 (tre) salla leximi, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka disponon fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, në të cilat gjëndet një numër tekstesh të fushës së programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermiore". Biblioteka shërben edhe si sallë interneti [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</p> <p>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabartë në përdorimin e saj. Literatura mësimore mund të shfrytëzohet në ambjentët e Bibliotekës ose dhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes së cilës siguron literaturën. Kartela personale e përdoruesit përmban informacione të tilla si numrin e kartelës, emër, mbiemër, atësinë, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit, numrin e telefonit, fakultetin, degën etj, si dhe nënshkrimin e përgjegjësit të bibliotekës dhe lexuesit. [Evidenca IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit]</p> <p>UGJ ka vënë në dispozicion të studentëve edhe përdorimin e librave elektronike ku ata mund të shfrytëzojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit "Eqrem Çabej" është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit Master Profesional në Shkenca Infermiore dhe degëve të tjera. Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare. Në Bibliotekë gjenden tituj nga fusha të ndryshme studimi. Të interesuarit gjejnë në Bibliotekë literaturë për çështje të përgjithshme dhe specifike për ekonominë, për filozofinë, psikologjinë, shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre, matematikën dhe shkencat e natyrës, shkencat e aplikuara si mjekësia dhe teknologjia, linguistika dhe letërsia, historia, gjeografia, si dhe materiale që trajtojnë artin, kulturën etj. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UGJ në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështur prej MAS, ka mundësuar për stafin akademik dhe studentet shërbimin "on-line" të Bibliotekës "U-Library". [https://ulibrary.rash.al/] Në faqen zyrtare web të UGJ -së, [https://uogj.edu.al/biblioteka-online/] personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë "on-line", literaturë të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur</p>

	udhëzimet e manualit përkatës. Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe personelin akademik. [Evidenca IV.14.1 Biblioteka, Manuali i përdorimit] Gjithashtu, nëpërmjet abonimit të Bibliotekës në revista shkencore ndërkombëtare online, studentëve/pedagogeve ju ofrohet mundësia e aksesimit të literaturës në gjuhë të huaj. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët, për kërkimin e literaturës qoftë për t'u përdorur përgjatë studimit qoftë për të realizuar temat e diplomës. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]			
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron shërbimin prej punonjësve të saj për studentët dhe personelin akademik ditët e javës, e Hënë-e Premte (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në orarin 8.00--19.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor por dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrje të Bibliotekës. Për çdo student ka kartelë personale të përdoruesit. [Evidenca IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës; Evidenca IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit]			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka ndjek dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurim të fondit fizik, dhe atij online. [Evidenca IV.13.1 raportime nga biblioteka për departamentin; Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë	UGJ është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSHA. Nëpërmjet platformave të ofruara prej tyre realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit online të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet Bachelor të UGJ-së.

Adresa: Rruga "Studenti"
Lagja "18 Shtatori", Gjirokastrë 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekanifshme@uogj.edu.al
Webste: <https://uogj.edu.al/>

<p>informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>si dhe matrikullimi i studentëve, bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UGJ, si në Bachelor ashtu dhe në Master Profesional.</p> <p>UGJ në përputhje me Neni 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 44] si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore [Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4] administron:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve. • Regjistrin e arritjeve akademike. • Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. <p>UGJ disponon gjithashtu sistemin elektronik Pitagora, aplikacion softuerik i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar), që ofron funksionalitete për administratën, sekretarinë dhe përdoruesit fundor (student, pedagog, etj.) [https://uogj.pitagora.rash.al/login]</p> <p>Disa nga funksionalitetet kryesore të kësaj platforme janë:</p> <p>Hapësira didaktike: Struktura Akademike, Menaxhimi i Karrierës së Studentit, Provime dhe Tema e Diplomës.</p> <p>Hapësira administrative: Pranimi dhe Regjistrimi, Orari dhe provimet, Menaxhimi i Studentëve.</p> <p>Tarifat: Menaxhimi i Tarifave të studimit, Bursa për studentët, Periudha Financiare</p> <p>Diplomimi: Provimet e Shtetit, Praktika studentore, Diploma Online dhe Suplementi</p> <p>Në UGJ ka funksionuar për disa vite edhe sistemi elektronik i automatizimit të proceseve të sekretarisë mësimore dhe shërbimeve online për studentët ESSE3 me funksionalitetet e përcaktuara në Rregulloren e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3.</p> <p>[Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në UGJ menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari Protokol menaxhon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrin themeltar • dosjet personale të punonjësve • librezat e punës së punonjësve <p>dhe çdo dokumentacion tjetër të dhënë nga Rektori, apo Administratori i Universitetit.</p> <p>[Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Nenet 3, 4, 5]</p> <p>Spektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve më Jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 82]</p> <p>Bazuar Rregulloren e FSHN [Evidenca I.5 Rregullore e FSHN, Neni 45], NJBI ruan me kujdes dokumentacionin përkatës në lidhje me personelin akademik si: ngarkesën vjetore mësimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, programet lëndore etj.</p>

Adresa: Rruga “Studenti”

Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekanifshn@uogj.edu.al

Website : <https://uogj.edu.al/>

	[Evidenca IV.8 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca IV.8.1. Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2022-2023]			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UGJ nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora [https://uogj.pitagora.rash.al/login], u siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente, të gjithë personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve të Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”. Personeli akademik dhe ndihmës akademik (sekretaria mësimore) ka akses në llogaritë e tyre, ku shfaqen të dhëna mbi lëndët mësimore, sezonet e provimeve, oraret e tyre, lista e studentëve të regjistruar, procesverbale provimi etj. Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që frekuentojnë, vlerësimet në çdo lëndë etj. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor, Struktura mësimore, Oraret mësimore etj. janë të publikuara edhe në faqen zyrtare ueb të UGJ -së. [https://uogj.edu.al/]			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve përfshijnë përveç faqes web dhe postës elektronike zyrtare edhe platformat elektronike si: Microsoft Office 365, Microsoft Teams etj. [https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesim-in-online/]; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet]			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platformat elektronike (ESSE3, Pitagora, Microsoft Office 365, Microsoft Teams, LearningKey) garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj. [Evidenca VI.8: Rregullore e NJSBC].			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare web të UGJ-së, bazuar në Statutin e UGJ [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 60], NJBI publikon: <ul style="list-style-type: none"> • Informacione që lidhen me programin e studimit si: Rregullorja e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor i tij, Struktura mësimore, Orari mësimor, kalendari i provimeve etj. • Informacione mbi NJBI dhe personelin akademik të tij. • Informacione mbi aktivitete të ndryshme etj të cilat janë në gjuhën shqipe dhe angleze. [http://uogj.edu.al/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.


Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UGJ harton një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Hartimi i këtij raporti financiar bazohet në Statutin e UGJ dhe bëhet sipas modelit të buxhetit të shtetit, i përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. [Evidenca L1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 103]</p> <p>Projekt buxheti vjetor hartohet nga Administratori i UGJ-së, mbi bazën e propozimeve të Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, mbështetur në Planin Strategjik të zhvillimit të UGJ-së, Planin buxhetor afatmesëm, dhe miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik. [Evidenca IV.16 Propozim buxheti NJBI; Evidenca IV.16.6 Propozim buxheti njësia kryesore; Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025, Kreu <i>Financat dhe Burimet Financiare</i>, faqe 34; Evidenca IV.16.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025]</p> <p>Pas miratimit buxheti i detajuar kalon për menaxhim në Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit institucional përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për Bibliotekën, për pasurimin e literaturës së saj si dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. [Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në mënyre periodike. Drejtorja e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, sipas kërkesave ligjore në fuqi ku paraqiten të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. [Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]</p> <p>Gjithashtu në mënyre periodike UGJ, si çdo institucion publik, i nënshtrohet auditit financiar prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MAS. [Evidenca IV.17 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve;</p>

Adresa: Rruga “Studenti”

Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastër 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekan@uog.edu.al

Website : <https://uog.edu.al/>



	Evidenca IV.17.1 Raport i MASR AUDIT 2018; Evidenca IV.17.2 Raport i MAS AUDIT 2022]			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Drejtorja e Shërbimeve Universitare dhe Administratori i UGJ-së raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës në Senatin Akademik të UGJ-së dhe Bordin e Administrimit. [Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Burimet e financimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si institucion publik janë dy: <ul style="list-style-type: none"> • Financim nga buxheti i shtetit. • Financim nga të ardhurat dytësore të cilat sigurohen nëpërmjet studentëve si: tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni. Më qëllim mirëmenaxhimit e këtyre fondeve dhe sigurimin e një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit. [Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



(Handwritten signatures)

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UGJ harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Pranimet e studentëve në UGJ në të gjitha programet e studimeve bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, kuotave dhe kriterëve të propozuara nga Njësia Bazë si dhe legjislacionin në fuqi. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 62; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 51; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN, Neni 18; Evidenca V.1 Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-IAL; Evidenca V.1.1 Urdhër i përbashkët RASH dhe QSHA Nr. 10 datë 10-07-2023, për miratimin e kalendarit 2023-2024; Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023-2024, Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit viti akademik 2024-2025; Evidenca V.2.2 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024. Evidenca II.10.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021, Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021 -2022, Evidenca II.12 Vendim Senatit Akademik për kriteret e pranimit 2021-2022, Evidenca II.12.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2021-2022, Evidenca II.13 Vendim Senatit Akademik për kriteret 2022-2023, Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023]</p> <p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” është 1 (nje) vit akademik. Programi i studimit është i organizuar në lëndë mësimore dhe i vlerësuar me 60 kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Studentët në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” diplomohen me provim formimi ose punim diplome.</p> <p>Me përfundimin e këtij programi studimi, lëshohet Diplomë Universitare Master Profesional në “Shkenca Infermiore”.</p> <p>[Evidenca II.9.1 Plani mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2020-2021; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”; Evidenca II.5 Model diplome Master Profesional në “Shkenca Infermiore”]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Statuti i UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 66, pika 4 dhe KREU X], përshkruan qartë kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë studimeve universitare, të cilat udhëtojnë nga parimi i barazisë.</p>

Adresa: Rruga “Studenti”

Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekanatsin@uog.edu.al

Website : <https://uog.edu.al/>

	<p>Rregullorja e UGJ-së , Rregullorja e FSHN-së dhe Rregullorja e NJBI-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN; Evidenca I.7 Rregullore e Njësisë Bazë të Infermierisë; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër] përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikat e transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Master Profesional në "Shkenca Infermiore". [Evidenca V.3 Dosja personale e studentit nga hyrja deri në diplomim; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve]</p> <p>Ne faqen zyrtare web të UGJ-së publikohen informacione mbi kriteret dhe kuotat e pranimeve për çdo vit akademik, si dhe Rregulloret institucionale për ecurinë akademike të studentëve.</p> <p>https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/; https://uogj.edu.al/statuti-i-universitetit/; https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>UGJ harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve propozohen nga Njësitë Bazë në përgjigje të kërkesës së MAS dy vite përpara, ndërsa kuotat e pranimeve një vit përpara fillimit të vitit akademik.</p> <p>[Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023-2024, Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit viti akademik 2024-2025; Microsoft Word - Shtojca 3 Kriteret cikli i dyte (uogj.edu.al); http://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/]</p> <p>Propozimet nga Njësitë Bazë, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati akademik. [Evidenca V.2.3 Vendim Senati Akademik Nr. 08 i datës 07.02.2023, për miratimin e kriterëve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024].</p> <p>Kuotat e pranimit të studentëve të ciklit të dytë, parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqipfolëse të shteteve të tjerë.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Pranimi i studentëve realizohet sipas sistemit meritë-preferencë, ku programet e studimit Master Profesional të ofruara nga UGJ, u bëhen të ditura paraprkisht kandidatëve për student në faqen zyrtare të web-it të UGJ-së. Në web publikohen kriteret dhe kuotat e pranimit, të përcaktuara për secilin program studimi Master Profesional. https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/</p> <p>Në Rregulloren e UGJ-së, Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FSHN-së përshkruhen kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes, ecuria akademike, procesi i transferimit dhe kriteret dhe procedurat e diplomimit. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.4</p>




Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>UGJ informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishëm studentët në vitin e parë të studimeve të tyre Master Profesional, në lidhje me procedurat e përparimit akademik.</p> <p>Me fillimin e vitit akademik, studentët marrin informacione të rëndësishme, në lidhje me procesin mësimor, planin mesimor, strukturën mësimore, orarin mësimor, pedagogun e lëndës, të publikara në ambjentet e FSHN-së si dhe në faqen zyrtare ueb të UGJ-së. [https://uogj.edu.al/]</p> <p>Në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve programet lëndore (syllabuset), procedurat për përparimin akademik, detyrimet mbi frekuencimin e lëndës, format e kontrollit të dijeve të fituara dhe vlerësimin të studentëve etj.</p> <p>Informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkruara hollësisht në Rregulloret institucionale. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI, VII; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN; Evidenca I.7 Rregullore e Njësisë Bazë të Infermierisë, Kreu V, VI, VII]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme për të cilat studentet mund të shprehin interes. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 72; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 65; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN]</p> <p>Informacion më i detajuar, sidomos në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm, merret pranë sekretarisë mësimore dhe nëpërmjet shpalljes së njoftimeve në stendat e informimit në UGJ.</p> <p>Procedura e njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore nga programi i mëparshëm i studimit në programin e studimit në UGJ kryhet nga Komisioni i njohjeve dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore, i ngritur pranë NJBKF. [Evidenca V.5 Ekuivalentim lëndesh mësimore; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studenteve]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloret institucionale [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI, VII; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN; Evidenca I.7 Rregullore e Njësisë Bazë të Infermierisë], NJBI informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit,</p>

	<p>duke përfshirë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe përmirësimin e notës. Ky informacion u bëhet me dije studentëve në fillim si dhe gjatë vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur në Kreun VIII Diplomimi, të Rregullores së Studimeve në UGJ, [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64], në Rregulloren e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 93] në Kreun “Diplomimi”, të Rregullores së FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e FSHN] në Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”, Kreu “Punimi i diplomës/provimi përfundimtar i formimit”], si dhe planin mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2020-2021], studentët në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.</p> <p>Në rregulloren e studimeve në UGJ dhe Rregulloren e FSHN-së përcaktohet qartë pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 59, pika 5; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN]</p> <p>NJBI asiston studentët, duke vënë në dispozicion të tyre informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të punimit të diplomës ose të provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>NJBI, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.</p> <p>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 61; Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve].</p> <p>Studentët të cilët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar asistohen nga NJBI, duke ju vënë në dispozicion të tyre Programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar. [Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Master Profesional në “Shkenca Infermiore”]</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UGJ organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e maturantëve dhe të interesuarve mbi programet e studimit në UGJ.</p>



Adresa: Rruga “Studenti”

Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekani@shn.ugj.edu.al

Website : <https://ugj.edu.al/>

udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UGJ informon gjithashtu edhe nëpërmjet spoteve televizive dhe fletëpalosjeve promovuese në lidhje me programet e studimit që ofron. [Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca V.4 Kalendarin e zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve Evidenca V.4.3 Fletëpalosje Universiteti; Evidenca V.4.4 Poster UGJ]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e UGJ-së si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” përcaktojnë qartë strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. [Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër; Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu VI, VII, Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”]</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, NJBI organizon takim informues me studentët e vitit të parë të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional, ku informohen rreth procesit mësimor, strukturës mësimore të vitit akademik, kohëzgjatjes së vitit akademik, ndarjes së tij në semestra, sezoneve të provimeve, planit mësimor dhe lëndëve mësimore përkatëse, objektivave formues të programit të studimit, Rregullores së Programit të studimit si dhe Rregulloreve të tjera institucionale, vendndodhjes së auditorëve, laboratorëve mësimore, zyrave dhe sekretarive, orarit mësimor, orarit të shfrytëzimit të Bibliotekës, përdorimit të faqes zyrtare web të UGJ-së etj.</p> <p>Informacionet e mësipërme mund të aksesohen elektronikisht edhe nëpërmjet faqes zyrtare web të UGJ-së.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>UGJ vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” informacion dhe dokumentacion udhëzues si Rregulloren e programit të studimit, plani mësimor me lëndët përkatëse, programet lëndore, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të tyre etj. [Evidenca 1.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore”; Evidenca II.9.1 Plani mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Infermiore” 2022-2023]</p> <p>Informacion i detajuar për studentët gjendet edhe në faqen zyrtare web të UGJ-së [www.uogj.edu.al].</p>

Adresa: Rruga “Studenti”

Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastër 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekanifsm@uogj.edu.al

Website : <https://uogj.edu.al/>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UGJ-ja informon, mbështet institucionalisht dhe orienton studentët drejt tregut të punës. Në këtë kuadër, UGJ merr pjesë në Panairin e Punës, ku shumë studentë prezantohen me informacione për punësim dhe punëdhënës të ardhshëm potencialë. [Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023]</p> <p>Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar u shërben studentëve të UGJ-së si urë lidhëse me tregun e punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënës të potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. [Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]</p> <p>Gjithashtu, UGJ-ja, ka realizuar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme, të cilat krahas ndihmës për procesin mësimor kanë shërbyer edhe si pikë tërheqjeje për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në UGJ. [Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ]</p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij procesi nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stendës së Informimit (struktura mësimore, plani mësimor, orari mësimor, kalendari i provimeve, njoftime etj • Pranë Njesisë Bazë (Përgjegjësi i Njesisë Bazë, Përgjegjësat e grupeve mësimore /kërkimore, titullarët e lëndëve) • Sekretarisë mësimore • Faqes zyrtare web • Njoftimi përmes postës zyrtare elektronike <p>Njoftime në rrjetet sociale</p>		
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë, nëpërmjet faqes zyrtare web të UGJ, postës zyrtare elektronike si dhe sistemit të sekretarisë mësimore [www.uogj.edu.al; https://uogj.pitagora.rash.al/login].</p> <p>Gjatë vitit akademik 2020-2021, për shkak të situatës së pandemisë, FNSH dhe stafi i tij akademik e zhvilluan procesin e mësimdhënies online, nëpërmjet platformës Teams. Marrja e masave të menjëherëshme që në fillim të vitit akademik, bëri të mundur zhvillimin me sukses të këtij viti akademik si edhe përmbuashjen e detyrimeve akademike lidhur me zhvillimin e sezoneve të provimeve në programin Master Profesional. [Evidenca III.1.9 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve në Universitetin "Eqrem Çabej", viti akademik 2020 -2021]</p> <p>http://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/ http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Teachers.pdf http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Students.pdf</p>		
<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UGJ disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master Profesional në "Shkencë Infermiere".</p> <p>Specialisti i Statistikës në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore mbledh, përpunon, ruan dhe paraqet informacione statistikore nëse kërkohen bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrin themeltar të studentëve; • regjistrin e arritjeve akademike; • regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave <p>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 92; Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve (Tabela 21); Evidenca V.6 Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UGJ disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, klasifikimin e studentëve të rinj në programet e studimeve sipas gjinisë, grupmoshave dhe vendbanimeve, të diplomuar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit etj. Të dhënat statistikore të gjeneruara nga sekretaria mësimore përfshihen në raportet vjetore të veprimtarisë së UGJ-së.</p> <p>[Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve (Tabela 21)]</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen manualisht dhe elektronikisht nëpërmjet Sekretarisë Mësimore (sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora). Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale nga UGJ bazohen në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna statistikore janë lehtësisht të aksesueshme nga personat e autorizuar. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 92, pika 3; Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe</p>	<p>UGJ mbështet me akte, kontrollin periodik të dokumentacionit pranë Njësive bazë, Njësive kryesore dhe Sekretarive mësimore, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. [Evidenca V.7 Kontroll dokumentacioni viti akademik 2018-2019; Evidenca V.7.1 Kontroll dokumentacioni viti akademik 2021-2022].</p>

Adresa: Rruga "Studenti"

Lagja "18 Shtatori", Gjirokastër 6001 Tel : +355 (04) 222-43423

Email: dekani@sm@uog.edu.al

Website : <https://uog.edu.al/>

dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UGJ bazuar në Raportet Vjetore të Njësive bazë, Raportet Vjetore të Fakulteteve, në raportime të Sekretarive mësimore, Drejtorisë së Shërbimeve Akademike-ndihmës akademike (Zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar), harton Raportin Vjetor Institucional ku përfshihen veprimtaria mësimore dhe shkencore, ecuria e programeve të studimit, informacione për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. [Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UGJ bazuar në Statutin e tij [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 88, pika 1 gërma b, f, Neni 91] nxit, përfshin dhe angazhon studentët dhe/ose përfaqësues të tyre në organet kolegjiale të tij. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik të UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 18, pikat 2, 3; Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik], në Këshillin e Etikës [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 24, pika 3], janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë statutin e organizimit dhe funksionimit të tyre [Evidenca V.8 Rregullore e organizimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor; Evidenca II.25 Statuti i Këshillit Studentor, Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor], janë të përfaqësuar në Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE TË dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)] dhe kanë Shoqatën Sportive Studentore të tyre. [Evidenca V.9 Statuti i shoqatës sportive UGJ; Evidenca V.11 Kërkesë për mbështetje financiare për shoqatën sportive studentore]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve	UGJ garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. [Evidenca I.1



<p>dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 88, pika 1 gërma b, Neni 91, pika 5] Ata përfaqësohen ose janë pjesë në organe në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore.</p> <p>Në Senatin akademik të UGJ-së studentët përfaqësohen në masën 10%. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 18, pikat 2, 3; Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik.</p> <p>Përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik të UGJ-së shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj. Studentët marrin pjesë në procese të rëndësishme të jetës institucionale dhe akademike, duke qënë anëtar të komisioneve zgjedhore institucionale. [Evidenca V.12 Rregullore e zgjedhjeve të 2020; Evidenca V.12.1 Vendimet e KIZ]</p> <p>Studentët organizohen lirisht në Këshillat Studentore, institucionale dhe në njësi kryesore. [Evidenca II.25 Statuti i Këshillit Studentor, Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor]</p> <p>Studentët janë anëtar të Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional si dhe Akreditimin e programeve të studimit. [Evidenca V.10 Vendim për ngritjen e GVB institucional; Evidenca V.10.1 Vendim për ngritjen e GVB të programit të studimit Master Profesional në "Shkenca Infermierore"]</p> <p>Studentët janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 24, pika 3; Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës; si dhe pjesë aktive e sondazheve vjetore të studentëve organizuar nga ASCAL dhe e sondazheve të organizuar nga UGJ. [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-Të dhëna për anëtarët e NJBI (Tabela 24)]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në hartimin dhe përmirësimin e programit Master Profesional në "Shkenca Infermierore" është parë me kujdes përcaktimi i ngarkesës mësimore të studenteve duke bërë një shpërndarje të mirë-balancuar midis semestrave sipas përcaktimeve të VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë". UGJ në Statutin e tij, [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë Çabej, Neni 88, gërma h, Neni 91, pika 5] garanton që studentët të shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të studimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.</p> <p>Përmës sondazheve të organizuara nga UGJ, konkretizohet e drejta e studentëve për t'u shprehur mbi cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi që ndjekin, si edhe për performancën e personelit akademik. Rezultatet dhe sugjerimet e marra nga procesi i anketimit të studentëve, pasqyrohen në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të përgatitur nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Raporti diskutohet me pas në NJBI, nga ku jepen sugjerimet konkrete për përmirësimin e rezultateve të matura. [Evidenca III.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Evidenca III.6 Procedura për</p>

	ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit; Evidenca III.7 Analiza e pyetësorit dhe përcjellja në fakultete]			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve përfshirë këtu edhe procesin e ankimit të rezultatit nga studenti është i sanksionuar në të gjitha Rregulloret institucionale. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VII; Evidenca I.5 Rregullore e FSHN; Evidenca I.7 Rregullore e NJBI; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu V] Çdo kërkesë, ankimim prej studentëve në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, parashikohet hollësisht në Rregulloren e studimeve në UGJ. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 46] Ankesa bëhet me shkrim brenda afatit të ankimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Ai përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në rast se vërtetohet praktika që bien ndesh me rregulloren atëherë me propozim të Përgjegjësit të Njësisë Bazë, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe rihënien e provimit. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 46, pika 2]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri I. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe Studentore, nëpërmjet zyrës së Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, informojnë dhe mbështesin studentët për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, shpërndarjen e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentët e rinj, dhënen e informacioneve për programet, kurrikulat e studimeve, diplomat, këshillimin e studentëve që përfundojnë ciklin e dytë të studimeve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me Njësitë Bazë dhe Kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UGJ-së, ofron për studentët trajnime, info day, takime të hapura etj. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 42; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14] Informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet Sekretarive mësimore, Zyrës së IT-së, Dejtorisë së Shërbimeve Universitare, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ku studenti merr asistencën e nevojshme në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike diplomimin, detyrimet dhe shërbimet financiare, pjesmarrje në mobilitete etj. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Nenet 42, 43, 44.]

	<p>Një rol të rëndësishëm në informimin dhe mbështetjen e studentëve për çdo problematikë në procesin mësimor ka edhe NJBI.</p> <p>Informimi i studentëve bëhet edhe nëpërmjet faqes zyrtare ueb të Universitetit dhe njoftimeve në rrjetet sociale (si Facebook, Instagram etj.).</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Informimi, këshillimi, ndjekja dhe përparimi i studentëve dhe mbështetja e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njesisë bazë (Përgjegjësi, Përgjegjësat e grupeve mësimore/kërkimore, titullarët e lëndëve, standës së informimit) - Sekretarisë Mësimore të FSHN - Sektorit të Standarteve dhe Kurrikulave - Zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, - Faqes zyrtare web - Sistemit të Sekretarisë mësimore (Pitagora) - Njoftimi përmes adresave zyrtare elektronike - Njoftime në rrjetet sociale (Facebook) etj. 			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, informacion për programet dhe kurrikulat e studimeve, diplomat, informon dhe këshillon studentët e UGJ-së që diplomohen në ciklin e dytë të studimeve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UGJ-së, ofron për studentët trajnime, info day, takime të hapura etj. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 42; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14]</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. [Evidenca V.13 Informacion mbi gjurmimin e studentëve dhe Formulari kontakti; Evidenca V.13.1 Korrespondenca për Këshillimin e Karrierës; V.13.2 Plani vjetor i punës i zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-it; Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Three handwritten signatures in blue ink are present at the bottom right of the page, likely representing the university's administration.

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UGJ harton udhëzues, manuale dhe kryen trajnime në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> <p>UGJ ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Proesional në Shkenca Infermierore] dhe duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale edhe metoda didaktike inovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 UGJ ofroi alternativën online të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet platformave elektronike të mësimiit në distancë, Office 365 dhe Microsoft Teams. Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesimin nga ana e studentëve dhe personelit akademik në këto platforma nëpërmjet mbështetjes nga personeli i IT i Universitetit si dhe ndihmoi me udhëzues dhe manuale të nevojshme teknologjike për përdorimin e këtyre platformave [Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimiit online; Evidenca III.1.1 Implementimi i platformes se mesimit online Classroom; Evidenca III.1.2 Implementimi i platformes se mesimit online Edumeeet; Evidenca III.1.3 Implementimi i platformes se mesimit online Office365; Evidenca III.1.4 Manual i perdorimit të platformes TEAMS per stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i perdorimit te platformes TEAMS per studentet; Evidenca III.1.6 Vendim per format e zhvillimit te procesit mesimor 2020-2021; Evidenca III.1.7 Rregullore per format e zhvillimit te provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati per miratimin e rregullores se provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.10 Oraret e provimeve online]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UGJ është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë funksionon Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikilave (SSCK) me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimit të lartë [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 93]</p> <p>SSCK-ja bazuar në Statutin e UGJ [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5] kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore</p>

	<p>shkencore, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara, organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional.[Evidenca III.6, Pyetesor Studentor; Evidenca II.23 Analizë mbi përshtatshmërinë e kurrikulave në UGJ; Evidenca III.7 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor, I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022]</p> <p>Gjithashtu në UGJ funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë [https://uogj.edu.al/kodi-cilesise/] dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë hapësirën Europiane të Arsimit të lartë.[Evidenca VI.8 rregullore e NJSBC, neni 3; Evidenca VI.8.1 anëtarët e NJSBC]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UGJ garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, gërma h, neni 91, pika 5]</p> <p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve arrihet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi • Pjesëmarrjes së studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, pika 1 gërma b] • Pjesëmarrjes së studentëve në Grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. [Evidenca V.10.1 Vendimi për ngritjen e grupit të vlerësimit brendshëm të programit të studimit] • Garantimit të së drejtës së studentit për ankimin e rezultatit të vlerësimit të dijes sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e studimeve në UGJ. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 42]
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>SSCK mbështetur në Statutin e UGJ, [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5, gërma h, I] hartojnë dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, së bashku me rekomandimet përkatëse.[Evidenca III.7 raport i analizës së pyetësoreve]</p> <p>UGJ nëpërmjet faqes zyrtare web [https://uogj.edu.al/transparenca/]; [Evidenca VI.6.1 Vendimi i miratimit për programin e transparencës 2021; Evidenca VI.6.2 Vendimi i miratimit të programit të transparencës 2023 i rishikuar], pasqyrojnë në mënyrë transparente dhe bën publike politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe të gjithë të interesuarit. në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave</p>


	2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023]			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>UGJ, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Të dhënat e pasqyruara nga mekanizmat e vlerësimit shërbejnë si instrument i rëndësishëm për përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik. [I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022, Evidenca I.12 Raport vjetor FSHN 2019-2020; Evidenca I.12.2 Raport vjetor FSHN 2020-2021; Evidenca I.12.4 Raport vjetor FSHN 2021-2022, Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.I 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.I 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJ.B.I 2021-2022]</p> <p>Këto rezultate nxitin personelin akademik për përmirësimin e veprimtarive të tyre mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore, përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies, përmirësimin të aftësive të mësimdhënies, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkëkohore mësimdhënëse etj.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>UGJ, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 103, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. [Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025]</p> <p>Në UGJ funksionon dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë (Kodin e cilësisë në arsimin e Lartë) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë. [Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC, neni 3; Evidenca VI.8.1 Anetaret e NJSBC]</p> <p>Në Statutin e UGJ [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94] si dhe Rregulloren e NJSBC [Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC, neni 5,6,7] përcaktohen qartë politikat dhe procedurat për për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>

	<p>Në UGJ funksionon Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 93,] strukturë përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ [Evidenca I.14 Organograma e Universitetit Eqrem Çabej]</p> <p>Në Statutin e UGJ, [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94,pika 5] përcaktohen qartë politikat dhe funksionet e Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave. [Evidenca III.6 Pyetësor Studentor, Evidenca II.23 Analizë mbi përshtatshmërinë e kurrikulave në UGJ; Evidenca III.7 Raport i analizës së pyetesorëve, Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave, Fakultetet, Departamentet) zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me aktore të ndryshëm [Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025] ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>Në bazë të Rregullores së NJSBC, [Evidenca VI.8 rregullore e NJSCB, neni 4] Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë pranë Rektoratit. Ajo përbëhet nga 7(shtatë) anëtarë, 4(katër) anëtarë janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, 2(dy) përfaqësues administrativ (zyra e kurrikulave dhe kërkimi shkencor) dhe 1(një) përfaqësues studentor.</p> <p>Në bazë të Statutit të UGJ [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 96, pika 2] për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional përfshihet një përfaqësues nga organizata studentore.</p> <p>Si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturanët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. [Evidenca I.23 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ, Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Në funksion të sigurimit të cilësisë UGJ ka realizuar me sukses procesin e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë. UGJ-ja ka marrë akreditimet periodike institucionale, me Vendim Nr.67, datë 21.09.2017 dhe Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. [https://uogj.edu.al/vendim-i-ba-dhe-ertifikata-e-akreditimit/; Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik]</p> <p>Gjithashtu, UGJ-ja përveç akreditimit institucional iu nënshtrua edhe vlerësimit nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2019 dhe 2022, rezultatet e të cilit</p>



	janë bërë publike prej ASCAL. [Evidenca VI.5 Sondazh Kombëtar te studentët].			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	SSCK bazuar në Statutin e UGJ [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5] kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore. SSCK organizon pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara, organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional, duke evidentuar sukseset dhe të metat me qëllim marrjen e masave për përmirësime në të ardhmen. [Evidenca III.6 Pyetësor Studentor, Evidenca II.23 Analizë mbi përshtatshmërinë e kurrikulave në UGJ] Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si instrument i rëndësishëm për përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik. Kjo analizë e hollësishme është një pikë referimi kyçe për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet dhe kriteret ligjore si dhe për të evidentuar mangësitë dhe masat që duhet të ndërmerren për tejkalimin e tyre. [Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të	UGJ përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të parë. Në nivel institucional, UGJ harton çdo vit Raportin vjetor bazuar në Raportet vjetore të Departamenteve dhe Fakulteteve ku përfshihen analizat e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor [I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022 Evidenca I.12.4 Raport vjetor i FSHN 2021-2022; Evidenca I.12.2 Raport vjetor i FSHN 2020-2021; Evidenca II.16.2 Raport vjetor i FSHN 2019-2020, Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2021-2022]



<p>njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, NJBI në vazhdimësi përmirëson kurrikulën e programeve të studimit që ofron [Evidenca II.112 Vendim NJBI- së për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022, Evidenca II.111 Plan mësimor Bachelor në IP 2018-2019, Evidenca II.1111 Plan mësimor Master Profesional në “Shkenca Infermierore” 2021-2022; Evidenca I.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FSHN]</p> <p>Gjithashtu UGJ në mënyrë periodike zhvillon anketime me studentët me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. [Evidenca VI.2 procedura për zhvillimin me sukses të sondazhit kombëtar të studentëve]</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. [Evidenca III.6, Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor]</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet vjetore institucionale dhe raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit si dhe adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. Sipas procedurës së analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit përveç raportit të analizës përpilohen edhe projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë duke e përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. [Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UGJ në kuadër të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programeve të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Çdo vit akademik hartohet Raporti Vjetor i UGJ-së ku pasqyrohet veprimtaria institucionale duke realizuar një analizë të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij</p> <p>FNSH/NJBI hartojnë Raportet Vjetore në të cilin vlerësohet mbarëvajtja e programeve të studimit</p> <p>NJBI përmirëson kurrikulën e programeve të studimit që ofron. Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së këtij programi studimi, janë përdorur disa metoda të drejtpërdrejta duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve. Në fillim të vitit akademik Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me stafin akademik kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e kurrikulave, syllabuseve etj. Në këtë të fundit pasqyrohen edhe rekomandimet e vitit të mëparshëm akademik për përmirësim të mëtejshëm të tij. Njëkohësisht në mënyrë të vazhdueshme Përgjegjësi i Departamentit realizon vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/ seminareve etj.</p> <p>SSCK harton Raport vjetor mbi vlerësimin e cilësisë dhe i bën ato publike</p>



	<p>Përgjegjësit e Departamenteve në bashkëpunim me titullarët e lëndëve në Njësitë Bazë mbikëqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera, ndjekin aktivitetin mësimor dhe shkencor të stafit akademik dhe ndihmësakademik dhe vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seancave laboratorike, detyrave të ndryshme apo testeve gjatë vitit akademik. [Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca I.12.4 Raport vjetor i FSHN 2021-2022; Evidenca I.12.2 Raport vjetor i FSHN 2020-2021; Evidenca I.12 Raport vjetor i FSHN 2019-2020, Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBI 2021-2022]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>UGJ në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program si dhe të atyre të diplomuar, organizimi i takimeve me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe Alumni [Evidenca III.6 Pyetësor studentor; Evidenca VI.5 Sondazh Kombëtar të studentët; Evidenca V.13 Formular gjurmimi të studenteve; Evidenca II.19 Te dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)] Shembull i ketyre takimeve është takimi i organizuar prej NJSBC në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve njerëzore, FSHN dhe FESHSH-në, të cilët organizuan workshop-in me temë "Studentët dhe tregu i punës". Qëllimi i këtij workshop-i ishte përmirësimi i kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni. Si bashkëpunëtor dhe ekspertë të jashtëm të ftuar në këtë tryezë ishin kryesisht biznese, institucione publike e private si punëmarrësit kryesorë të studentëve të UGJ-së. [Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>



Three handwritten signatures in blue ink.

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UGJ parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Bazuar në statutin e UGJ-së, [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 93] struktura përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ-së është Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave. [Evidenca I.14 Organograma e Universitetit Eqrem Çabej]</p> <p>Gjithashtu në UGJ funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë (Kodin e cilësisë në arsimin e lartë) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë. [Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC, neni 3; Evidenca VI.8.1 Anetaret e NJSBC]</p> <p>Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave mund të angazhojë periodikisht ekspertë të jashtëm për çështje specifike ose/dhe specialistë të niveli të lartë të fushës së sigurimit të cilësisë sipas nevojës për konsulentë, ekspertizë ose për çështje të tjera. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94, pika 2]</p> <p>Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merret pjesë edhe një përfaqësues nga organizata studentore. Në rast nevojë ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 96, pika 2; Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC, neni 7, pika 2; Evidenca VI.8.1 Anetaret e NJSBC]</p> <p>Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, zyra e Alumni, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të vazhduar pranë UGJ-së është pjesëmarrëse dhe promovuese e programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturanët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. [Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023; Evidenca VI.7 Takime alumni me studentët]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UGJ përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Detyrat konkrete dhe përgjegjësitë shtrihen në rang Njësie bazë, për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Ato analizohen në mënyrë koherente mes anëtarëve të departamentit dhe njësive përgjegjëse të monitorimit të veprimtarisë së tij. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, NJBI ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, nenet 12, 13; Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC; Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së]</p>

<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FSHN; Evidenca I.7 Rregullore e NJBI; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit MP në SHI]</p> <p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p>Në Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 28, pika 5] është parashikuar dhe ngritja në nivel fakulteti e komisioneve e garantimit të cilësisë së njësisë kryesore dhe programeve të studimit me përfaqësues të personelit akademik dhe atij ndihmës administrativ me karakter mësues dhe përfaqësues të studentëve.</p> <p>DIF është përgjegjës për programet e studimit që ofron, si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtyre programeve në bashkëpunim me të gjitha nivelet e strukturave përbërëse të UGJ-së, kjo bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullore që institucioni ka të parashikuar. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, nenet 12,13; Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore FSHN Evidenca I.7 Rregullore e NJBI; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit MP në SHI]</p> <p>NJB ngre njësinë e sigurimit të cilësisë së brendshme, në të cilën përfshihen anëtarët e departamentit dhe të paktën 1 student. Kjo njësi monitoron organizimin dhe format e mësimdhënies, cilësinë dhe kontrollin e njohurive. Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë dhe ofrimit të programit të studimit është proces i vazhdueshëm. [Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC-se, Neni 7, pika 2]</p> <p>Njëkohësisht një tjetër tregues që dëshmon përfshirjen e studentëve është pyetësi i organizuar prej NJSBC për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe Sondazhi Kombëtar i studentëve. [Evidenca III.6 Pyetësor Studentor; Evidenca VI.5 Sondazh Kombëtar te studentët]</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Proceset e vlerësimit respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Ato respektojnë lirinë dhe etikën akademike, [Evidenca III.10 Kodi i Etikës] dhe mbështeten në Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.si dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UGJ. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet nga studentët e kursit në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre. [Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, Evidenca I.1, Statuti I UGJ, neni 6]</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në</p>	<p>Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij.</p> <p>Pjesëmarrja dhe promovimi i programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluara nga Departamenti i Infermierisë, në bashkëpunim me zyrën e Alumnit, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të vazhduar pranë UGJ-së në bashkëpunim me maturanët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës u shërben</p>



lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	studentëve për një qasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe intershipi. Në këto panairë marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat ofrojnë ndaj studentëve pozicionet e tyre vakante dhe japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. [Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UGJ nëpërmjet faqes zyrtare web dhe programit të transparencës [https://uogj.edu.al/transparencja/], në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bën publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit mekanizmat kontrollues dhe monitorues si Planet strategjike të punës në UGJ, Planet e veprimtarive akademike kërkimore shkencore vjetore në UGJ, Raporte monitorimi për cilësinë e pogrameve të studimit, Raporte të vlerësimit të brëndshëm për akreditimin institucional, Raporte të vletësimit të jashtëm për akreditimin institucional, Raporte monitorimi të performancës në Universitet etj [https://uogj.edu.al/transparencja/]
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UGJ në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit, respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. [Evidenca III.6 Pyetesor Studentor; Evidenca VI.5 Sondazh Kombëtar të studentëve; Evidenca III.7 Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor; Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; Evidenca III.10 Kodi i Etikës]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Procedura e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit, që ofron Njësia Bazë, miratohet me vendim të Senatit Akademik. Raportit i bashkëngjiten edhe projektpropozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë duke e përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve Në përfundim të zbatimit të të gjithë fazave të parashikuara në procedurën e mësipërme përpilohet plani i masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit dhe mësimdhënies, i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit. Rezultatet e vlerësimit adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara si dhe përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik. [Evidenca I.21.1 Plani i veprimit për akreditimin institucional periodik; Evidenca I.21.2 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e planit të veprimit; Evidenca III.7 Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022, Evidenca II.16

	Raport vjetor i FSHN 2021-2022, Evidenca L13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore NJBI 2021-2022]			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të UGJ-së e për këtë harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm ku adresohen pikat e forta dhe të dobëta, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Edhe rekomandimet e lëna institucionit në kuadër të akreditimit institucional kanë shërbyer për përmirësimin e cilësisë së punës dhe ofrimit të shërbimeve dhe janë plotësuar nga institucioni. [Evidenca III.7 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor]			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë, UGJ organizon aktivitete dhe seminare informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion Më konkretisht nëpërmjet: - Takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore; Plotësimin të pyetësorëve, pjesëmarrjes në Sondazhe Kombëtare të Studentëve - Publikimit të njoftimeve në rrjetet sociale të Universitetit. - Publikimit të njoftimeve në email-et zyrtare etj. [Evidenca VI.7 Takime të studentëve me ALUMNI, Evidenca II.15 Pjesëmarrje ne Panair Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje ne Panair Work and Study 2023]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Shkenca Infermierore”

Pikat e forta dhe afirmime

1. UGJ dhe Departamenti i Infermierisë ofrojnë një program studimi të ciklit të dytë Master Profesional në “Shkenca Infermierore”, i cili falë pozicionit gjeografik të Universitetit “Eqrem Çabej” është i vetmi në llojin e tij në rajonin e jugut të Shqipërisë.
2. Plani mësimor i programit të studimit, është organizuar bazuar në praktikat më të mira europiane dhe duke patur parasysh specifikat kombëtare dhe kriteret për profesionet e rregulluara në vendin tone.
3. FSHN/Departamenti i Infermierisë disponon infrastrukturën e nevojshme fizike dhe laboratorike për të realizuar sa më mirë procesin e mësimdhënies dhe praktikave mësimore për studentët e këtij programi studimi. Ekzistenca e Laboratoreve mesimore-kërkimore në FSHN, bën të mundur realizimin e një procesi mësimor bashkëkohor për studentet e këtij programi studimi.
4. FSHN/Departamenti i Infermierisë ka një staf akademik të paisur me tituj dhe grada shkencore, të kualifikuar dhe me eksperiencë akademike, si edhe profesionistë në fushën e Mjekësisë dhe Infermierisë, të nevojshme për këtë program studimi.
5. UGJ dhe FSHN ka marrëveshje me një sërë institucionesh publike për të mundësuar kryerjen e praktikave profesionale të studentëve
6. FSHN/Departamenti i Infermierisë ka marrë pjesë në projekte me disa universitete të huaja, duke mundësuar mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi në kuadër të programeve Erasmus +.
7. Biblioteka e UGJ-së (hardcopy dhe elektronike), siguron dhe plotëson kërkesat e stafit akademik dhe studentëve me literaturën bazë dhe ndihmëse për nevojat e procesit mësimor si dhe kërkimin shkencor.
8. Nivel optimal studentësh në këtë cikël studimi dhe nivel i lartë i punësimit të tyre.

Pika të dobta

1. Pamunësia për mbulimin e praktikës me staf akademik me titullin “Doktor” për shkak të mungesës së stafeve akademike të fushës së infermieristikës në nivel kombëtar.
2. Nuk ka një platformë strategjike për mbështetjen e kërkimit shkencor për studentët e këtij programi studimi.
3. Përfshirja e kufizuar e studentëve në veprimtaritë kërkimore të Njesisë Bazë lidhur me këtë program studimi.
4. Mospasja e studentëve jashtë rajonit jugor, gjë e cila sjell mungesën e krijimit të një ambjenti të diversifikuar social dhe mungesë shkëmbimi eksperiencash studentore.
5. Mungesë gjurmimi të saktë për procesin e punësimit të studentëve që ikin jashtë vendit.



Rekomandime:

1. Në bashkëpunim me Urdhrin Rajonal të Infermierit të mundësohet bërja e një studimi të mirëfilltë i tregut të punës nga NJBI, në lidhje me zhvillimet aktuale dhe ato të pritshme në vendin tonë dhe jashtë vendit, me qëllim identifikimin e nevojave dhe kërkesave të tregut të punës lidhur me punësimin e studentëve që diplomohen në këtë program studimi.
2. Konsolidimi i programit egzistues nëpërmjet kurikulës egzistuese shoqëruar dhe me ndryshimet e nevojshme në literaturën bazë. Të bëhet përmirësim i mëtejshëm i programit në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë dhe zhvillimet e reja në fushën e mjekësisë.
3. Aplikime për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për financime në infrastrukturë në funksion të programit dhe mobilitet të stafit dhe studentëve.
4. Të krijohet mundësia për organizimin e veprimtarive shkencore në formën e konferencave, seminareve shkencore periodike.

Evaluation's Conclusions for the Study Program Master of Professional Nursing

Strengths and affirmations

1. The University of Gjirokaster and the Nursing Department offer a second-cycle study programme, Master of Professional Nursing, which thanks to the geographical position of this institution, is the only one of its kind in the southern region of Albania.
2. The curriculum of this study program has been organized based on the best European practices and taking into account the national specifics and the criteria for the regulated professions in Albania.
3. The Nursing Department, as an integral part of the Faculty of Natural Sciences, has the necessary physical space and laboratory infrastructure to carry out as best as possible the teaching process and the required hours of practice for the students of this study program.
The existence of laboratories suitable for teaching and research makes it possible to realize a contemporary teaching process for our students.
4. This study programme is covered by academic staff with scientific degrees and academic titles, also with the needed academic and professional experience in the field of Medicine and Nursing.
5. The University of Gjirokaster has agreements with several public health institutions to enable internships for our students.
6. The Faculty of Natural Sciences/ Nursing Department has participated in international projects, enabling mobility for the academic staff and students within the Erasmus programme.



7. The University of Gjirokastrë's library (hardcopy and electronic), provides and meets the requirements of academic staff and students with basic and auxiliary literature for the needs of the teaching process as well as scientific research.
8. An optimal number of students in this study programme and high employment level.

Weak points

1. Due to the national lack of academic staff with Ph.D. degrees in Nursing Sciences, this study programme is not completely covered by the suitable academic staff.
2. There isn't a strategic plan for scientific research in support of our students.
3. Limited involvement of students in the scientific research of the Nursing Department.
4. The lack of students coming from outside the southern region reduces the possibility of creating a diversified social environment and exchange of experiences between them.
5. Many of our students emigrate to EU countries and beyond but we don't have yet an accurate tracking system for their employment level.

Recommendations

1. The Nursing Department in cooperation with the Order of Nurses, should conduct a proper study of the labor market considering the current and expected developments in our country and abroad, in order to adapt this study programme to the needs and requirements of the labor market in the near future.
2. Consolidation of this study programme by making the necessary changes in the actual curriculum, mainly in basic literature and to further improve this programme in accordance with Albania's higher education law and new developments in the nursing sciences.
3. Increasing applications on national and international projects for funding in infrastructure, mainly in laboratories, in the function of the study program, and mobility of staff and students.
4. To find opportunities and manage the organization of scientific activities in the form of conferences and periodic scientific seminars.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeeve të studimit

Lista e mëposhtme është dokumentacioni i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programeeve të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë, por në një dokument mund të përmbliidhen disa nga të dhënat e kërkuara. Në rastin e programeeve të ciklit të dytë (Master i Shkencave) dhe të ciklit të tretë (Specializim Afatgjatë dhe Doktoratë) i gjithë ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqip dhe angleze ashtu si dhe RVB. Në cdo rast bazohuni në Manualin për "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeeve të studimit"

1. Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë Programmin;
2. Dosja e programmit të studimit e plotësuar me të gjitha elementët e nevojshëm;
3. Rregullore e programmit të studimit;
4. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programmin e studimit;
5. Strategjia e zhvillimit të programmit;
6. Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare;
7. Politika të burimeve njerëzore, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe përzgjedhjen;
8. Politika e zhvillimit të stafit akademik;
9. Struktura organizative e IAL dhe programeeve;
10. Politika e jashtëm për mobilitetin e stafit dhe studentëve;
11. Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie;
12. Politika të vlerësimit akademik të stafit e mësimdhënies;
13. Rregulloret për testimet e provimet, kriteret dhe procedurat e diplomimit etj;
14. Diplomat dhe suplementet e diplomave;
15. Procedurë dhe ankimimi për studentët;
16. Procedurë për mbështetjen, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeeve të studimit;
17. Procedura për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;
18. Politika e pranimi të studentëve;
19. Procedura e regjistrimit të studentëve, databaza e studentëve/regjistri;
20. Politika të mbështetjes, përkrahjes, u etj për studentët dhe struktura organizative të tyre;
21. Veprimtaria kërkimore, monitorimi dhe rezultatet në nivel programmi;
22. Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programmit;

